



Miratohet në parim Buxheti i Mbrojtjes 2026, Ministri i Mbrojtjes Vengu: Hap historik për modernizimin e FA-së dhe ringritjen e industrisë ushtarake shqiptare



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI NË NAPOLI: SHQIPËRIA RIAFIRMON ANGAZHIMIN NDAJ PLANIT JUGLINDOR TË NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtnant Arben Kingji, mori pjesë në Konferencën Koordinuese të Komandantëve të Krahut Jugor të Aleancës, e organizuar nga Komanda e Forcave të Bashkuara Aleate në Napoli (JFC Naples). Konferenca mbledhi drejtues ushtarakë të vendeve aleate të rajonit...



faqe 2



KONFERENCA NDËRKOMBËTARE SHKENCORE MBI INOVACIONIN E INDUSTRIËS SË MBROJTJES ZHVILLOHET NË AFA: TRE PRIORITETE STRATEGJIKE PËR TË ARDHMEN E INDUSTRIËS SË MBROJTJES SHQIPTARE

Në Akademinë e Forcave të Armatosura u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare Shkencore “Rivitalizimi dhe Inovacioni i Industrisë së Mbrojtjes”, një aktivitet i rëndësishëm shkencor i organizuar nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, i cili mbledhi ekspertizë kombëtare...



faqe 4



SHËRBIMI KIMIK I USHTRISË: NGA THEMELI TE MODERNIZIMI I NJË ARME ELITARE

Shërbimi Kimik i Ushtrisë ka qenë një ndër shërbimet më elitare dhe më të rëndësishme të Forcave të Armatosura, një strukturë që përgjigjet drejtpërdrejt para Këshillit të Mbrojtjes për shkak të natyrës delikate, kompleksitetit dhe rëndësisë strategjike të detyrave që i ngarkoheshin. Gjatë një periudhe 72-vjeçare...



faqe 6

Gjeneralletënant Arben Kingji në Napoli: Shqipëria riafirmon angazhimin ndaj Planit Juglindor të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralletënant Arben Kingji, mori pjesë në Konferencën Koordinuese të Komandantëve të Krahut Jugor të Aleancës, e organizuar nga Komanda e Forcave të Bashkuara Aleate në Napoli (JFC Naples).

Konferenca mbledhi drejtues ushtarakë të vendeve aleate të rajonit, ku diskutimet u përqendruan në përshtatjen dhe forcimin e Planit Juglindor të NATO-s, një komponent strategjik për mbrojtjen kolektive dhe gatishmërinë e Aleancës në zonën juglindore.

Gjatë fjalës së tij, gjeneralletënant Kingji theksoi angazhimin e palëkundur të Shqipërisë dhe të Forcave të Armatosura për zbatimin e këtij plani, duke nënvizuar se vendi ynë kontribuon në mënyrë të qëndrueshme si në detyrimet ndaj Aleancës, ashtu edhe në përgjegjësitë kombëtare për sigurinë.

Ai vuri në dukje se Shqipëria mbetet një partner i besueshëm në përpjekjet e përbashkëta për forcimin e arkitekturës së sigurisë euroatlantike, duke e përmbyllur me mesazhin: “Stronger Together”.



Gjeneralletënant Arben Kingji pret ish-Shefat e Shtabit të Përgjithshëm: Fokus te modernizimi i FA dhe siguria rajonale

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralletënant Arben Kingji, priti në një takim të veçantë ish-shefat e Shtabit të Përgjithshëm, në kuadër të një tradite që vlerëson përvojën dhe kontributin e drejtuesve të lartë ushtarakë ndër vite.

Gjatë takimit, u zhvillua një diskutim i hapur dhe i frytshëm mbi procesin e zhvillimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura, me theks te transformimi strukturor, rritja e kapaciteteve operacionale dhe përshtatja e forcave me sfidat bashkëkohore të sigurisë.

Gjeneralletënant Kingji vlerësoi lart kontributin e ish-drejtuesve të FA-së, duke theksuar rëndësinë e këshillave dhe perspektivave strategjike që ata sjellin në proceset aktuale të zhvillimit.

Në takim u diskutua gjithashtu situata e përgjithshme e sigurisë në rajon dhe më gjerë, me vëmendje të veçantë ndaj sfidave që ndikojnë arkitekturën e sigurisë euroatlantike.

Takimi u mbyll me angazhimin për të vijuar bashkëpunimin dhe këmbimin e përvojave, në funksion të forcimit të mëtejshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.



Miratohet në parim Buxheti i Mbrojtjes 2026, Ministri i Mbrojtjes Vengu: Hap historik për modernizimin e FA-së dhe ringritjen e industrisë ushtarake shqiptare

Buxheti i Mbrojtjes për vitin 2026, është miratuar në parim gjatë seancës plenare, ku ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, e cilësoi këtë buxhet si një kthesë strategjike drejt modernizimit të Forcave të Armatosura, ringritjes së industrisë ushtarake dhe forcimit të kapaciteteve të emergjencave civile.

Me një rritje prej 12% krahasuar me vitin 2025, buxheti i Mbrojtjes arrin në 58.9 miliardë lekë, ose 2.12% të PBB-së. Ministri Vengu theksoi se ky nivel investimi nuk është thjesht plotësim i një kriteri të NATO-s, por një vendim politik që i jep mbrojtjes peshën që i takon në vizionin për “Shqipërinë 2030”.

Fokus te personeli dhe kapitali njerëzor

Rreth 13 miliardë lekë janë dedikuar për personelin me uniformë, duke përfshirë rritjen e pagave, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe krijimin e mundësive të reja të karrierës për të rinjtë që synojnë t'i bashkohen Forcave të Armatosura apo Mbrojtjes Civile. Ministri theksoi se ky investim “jep dinjitet dhe besim”, si edhe synon të forcojë lidhjen mes rinisë dhe FA-së, përmes politikave moderne të burimeve njerëzore dhe kurrikulave inovative në bashkëpunim me arsimin e lartë.

Rritje e kapaciteteve operacionale dhe investimeve kapitale

16.3 miliardë lekë të tjera do të shkojnë për rritjen e gatishmërisë operacionale nga pajisjet dhe uniformat, te kapacitetet detare e ajrore, logjistika, stërvitja dhe angazhimet ndërkombëtare. Ndërkohë, 29 miliardë lekë janë planifikuar si investime kapitale për modernizim teknologjik, dixhitalizim dhe fuqizimin e industrisë vendase ushtarake.

Ringritja e industrisë “Made in Albania”

Ministri Vengu theksoi se industria ushtarake shqiptare po rikthehet fuqishëm, duke prodhuar municione, dronë, sisteme anti-dron, mjete të blinduara dhe pajisje personale. Sipas tij, kjo industri po gjeneron 326 vende të reja pune dhe po kthehet në burim të ardhurash për ekonominë.

Prioritetet në Mbrojtjen Kibernetike dhe Emergjencat Civile

Një vëmendje të veçantë merr mbrojtja kibernetike dhe inovacioni, ndërsa në fushën e emergjencave civile janë parashikuar 4.3 miliardë lekë për ndërtimin e dy qendrave rajonale, blerjen e dy

avionëve zjarrfikës dhe forcimin e kapaciteteve të menaxhimit të krizave.

Në përmbyllje, ministri Vengu deklaroi se ky buxhet përfaqëson vizionin për një shtet më të fortë, më të sigurt dhe më të besueshëm, si në sytë e qytetarëve ashtu edhe të aleatëve ndërkombëtarë.



Regjimenti i Mbështetjes me Luftim mirëpret atashetë ushtarakë të akredituar në Shqipëri

Regjimenti i Mbështetjes me Luftim priti në një vizitë zyrtare atashetë ushtarakë të akredituar në vendin tonë, përfaqësues nga Turqia, Republika Çeke, Bullgaria, Polonia, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar.

Vizita synoi forcimin e bashkëpunimit me aleatët si dhe shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të mira në fushën e mbështetjes me luftim dhe operacioneve mbështetëse të Forcave të Armatosura.

Gjatë takimit, përfaqësuesit u njohën me kapacitetet, misionin dhe strukturën operacionale të Regjimentit të Mbështetjes me Luftim, duke diskutuar mënyrat për rritjen e bashkëpunimit të mëtejshëm në kuadër të partneritetit dhe angazhimeve të përbashkëta në NATO.

Kjo vizitë nënvizon rëndësinë e marrëdhënieve të forta me aleatët dhe përkushtimin për të vijuar ndërtimin e kapaciteteve të përbashkëta, duke dëshmuar edhe një herë se “Stronger Together” është më shumë sesa një moto është një realitet i bashkëpunimit ushtarak të Shqipërisë.



Në Akademinë e Forcave të Armatosura u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare Shkencore “Rivitalizimi dhe Inovacioni i Industrisë së Mbrojtjes”, një aktivitet i rëndësishëm shkencor i organizuar nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, i cili mbledhi ekspertizë kombëtare dhe ndërkombëtare për të trajtuar të ardhmen e industrisë së mbrojtjes.

Në konferencë morën pjesë drejtues të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, si edhe përfaqësues të Komandës së NATO-s për Transformim (ACT), përfaqësues nga industria e mbrojtjes së Polonisë, Mbretërisë së Bashkuar, Turqisë dhe kompani të industrisë së mbrojtjes në Shqipëri.

Zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Blerina Abraxhda, theksoi se inovacioni, teknologjia dhe bashkëpunimi ndërkombëtar janë elementët kyç në zhvillimin e një industrie të qëndrueshme të mbrojtjes, duke vlerësuar rëndësinë e një qasjeje moderne dhe të integruar.

Gjatë punimeve u prezantuan 18 punime shkencore, nga të cilat 9 u diskutuan në panele të specializuara, duke sjellë ide konkrete dhe rekomandime për modernizimin teknologjik, zhvillimin e kapaciteteve vendase dhe forcimin e komponentëve të kërkimit shkencor në mbrojtje.

Në përmbyllje, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj paraqiti tre rekomandimet strategjike që dolën nga diskutimet:

- Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Industrisë së Mbrojtjes
- Investime të qëndrueshme në kapital njerëzor, kërkim shkencor dhe teknologji
- Forcimi i partneriteteve ndërkombëtare dhe kapaciteteve vendase të prodhimit

Materialet dhe përfundimet e konferencës pritet të shërbejnë si bazë orientuese për planifikimin afatgjatë të zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe për ringritjen e industrisë kombëtare të mbrojtjes, duke e vendosur inovacionin dhe modernizimin në qendër të vizionit strategjik të sektorit.



Konferenca Ndërkombëtare Shkencore mbi Inovacionin e Industrisë së Mbrojtjes zhvillohet në AFA: Tre prioritete strategjike për të ardhmen e industrisë së mbrojtjes shqiptare



Ushtari Hambel Peçi shpallet “Ushtari/Nënoficeri i Vitit 2025” – ROS dominon garën prestigjioze

Ushtari i Forcave të Armatosura, Hambel Peçi nga Regjimenti i Operacioneve Speciale (ROS), është shpallur fitues i vendit të parë në garën “Ushtari/Nënoficeri i Vitit 2025”, një aktivitet i rëndësishëm i FA-së që synon të vlerësojë profesionalizmin, aftësitë intelektuale dhe cilësitë individuale të efektivëve më të spikatur.

Në këtë garë tradicionale, ku konkurrojnë ushtarë dhe nënoficerë nga të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura, Peçi u dallua për performancën e tij të shkëlqyer, përgatitjen fizike dhe disiplinën profesionale, elemente që e çuan në krye të vlerësimit.

Vendi i dytë dhe i tretë për nënoficerët e talentuar

Vendin e dytë e zuri Nëntetar Marius Cauli nga Regjimenti i Këmbësorisë së Jugut, i cili u vlerësua për aftësi të qëndrueshme taktike dhe përkushtim të lartë në detyrë.

Vendi i tretë i shkoi Nëntetar Hil Mala nga Regjimenti i Operacioneve Speciale, duke i dhënë ROS-it edhe një tjetër pozicion në podium.

Ky aktivitet vjetor synon të promovojë kulturën e ekselencës brenda Forcave të Armatosura dhe të evidentojë efektivët që spikasin në profesionalizëm, moral dhe përgatitje të gjithanshme. Fituesit e këtij viti konfirmojnë standardet e larta dhe përpjekjet e vazhdueshme të FA-së, për forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe profesionalizmit në radhët e saj.



Stërvitje komplekse fushore për kursantët e Kursit Bazë të Oficerit në Bizë

Gjatë kësaj jave, 90 kursantë të Kursit Bazë të Oficerit po zhvillojnë stërvitjen komplekse fushore në terrenin e Bizës, duke sfiduar kushtet e vështira atmosferike. Ushtrimet po zhvillohen nën drejtimin e instruktorëve të Shkollës së Trupës dhe përbëjnë një nga fazat më sfiduese të përgatitjes së tyre profesionale. Qëllimi i stërvitjes është thellimi i njohurive profesionale, si dhe rritja e aftësive drejtuese të kursantëve nën ngarkesë fizike dhe psikologjike. Terreni, moti dhe dinamika e ushtrimeve i vendosin ata përballë skenarëve të ngjashëm me situatat reale të operacioneve, duke i forcuar, disiplinuar dhe përgatitur për sfidat e së ardhmes si oficerë të Forcave të Armatosura. Kjo fazë e stërvitjes është thelbësore për zhvillimin e aftësive taktike dhe komanduesve të rinj, duke u orientuar drejt profesionalizmit dhe gatishmërisë operative.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Leximi, aset kombëtar në formimin e efektivit ushtarak

Në një kohë kur sfidat ndaj sigurisë kombëtare po diversifikohen nga kërcënimet hibride, tek dezinformimi dhe polarizimi social, Shqipëria përballlet me nevojën për të forcuar jo vetëm mbrojtjen fizike, por edhe atë kulturore e mendore.

Në këtë panoramë, libri mbetet një armë strategjike dhe e pazëvendësueshme. Ndërgjegjja shqiptare, përfshirë ndërgjegjen e efektivit ushtarak, ka nevojë për formim të vazhdueshëm intelektual, kulturor dhe moral. Një shoqëri që lexon është një shoqëri e fortë. Një trupë ushtarake që lexon është një forcë që mendon, analizon dhe vendos me maturi.

Përballë ndikimeve të shpejta teknologjike dhe informacionit shpesh të pa filtruar, libri ofron stabilitet, qartësi dhe profesionalizëm, vlera që janë esenciale për çdo forcë të armatosur moderne.

Kultura e Leximit, shtylla morale e Forcave të Armatosura

Shumë ushtri të NATO-s prej kohësh e konsiderojnë librin pjesë të infrastrukturës së mbrojtjes. Librat për strategjinë ushtarake, historinë, psikologjinë e konfliktit, lidershipin dhe etikën profesionale përbëjnë themelin e çdo oficeri dhe nënoficeri të gatshëm. Edhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë përfituar historikisht nga individë të formuar përmes librit, studiues të strategjisë, historianë, komandantë me kulturë të gjerë dhe ushtarakë që kanë kuptuar qartë rolin e tyre në shtet dhe shoqëri.

Libri zhvillon aftësi të domosdoshme për uniformën:

- Mendimin kritik, i cili është vendimtar në situata operacionale.
- Qartësinë profesionale, në një kohë kur misionet janë shumëdimensionale.
- Lidershipin, që nuk ndërtohet vetëm në fushë, por edhe në dije.
- Kuptimin e historisë, pa të cilën nuk formohet identiteti ushtarak.

Një oficer që lexon, komandon më mirë. Një nënoficer që lexon, kupton më thellë. Një ushtar që lexon, është qytetar më i vetëdijshëm.


Kriza e librit në Shqipëri dhe pasojat e saj për shoqërinë

Shqipëria sot përballlet me një krizë leximi që, ndonëse e dukshme në nivel civil, ka pasoja më të gjera për gjithë vendin.

Rënia e kulturës së leximit dobëson kohezionin shoqëror

Shqiptarët po jetojnë në një ritëm të shpejtë, shpesh të shkëputur nga reflektimi dhe analiza. Kjo krijon

Libri si Armatim i Mendjes në Epokën e Dezinformimit



hapësirë për manipulim, dezinformim dhe përçarje, tre fenomene që dëmtojnë sigurinë kombëtare.

Informacioni i shpejtë nuk zëvendëson dijen

Të rinjtë po zëvendësojnë librin me përmbajtje të fragmentarizuar në rrjetet sociale. Brenda këtij realiteti, formimi i thellë profesional humbet terren.

Zbehja e vlerave morale

Libri ndërton karakterin. Mos-prania e tij lejon deformime të vlerave themelore, duke prekur edhe integritetin e institucioneve.

Roli i Forcave të Armatosura në promovimin e kulturës së librit

Ushtria, si një nga institucionet më të besueshme të shtetit shqiptar, ka kapacitetin dhe autoritetin për të qenë model në ringritjen e kulturës së leximit.

Krijimi i klubeve të leximit në repartet ushtarake

Këto klube jo vetëm nxisin kulturë, por edhe forcojnë lidhjen midis efektivëve, duke ndërtuar kohezion, besim dhe aftësi komunikimi.

Promovimi i literaturës profesionale

Nga manualët ushtarake te librat për strategji, diplomaci dhe histori ushtarake botërore, çdo repart mund të ndërtojë bibliotekën e vet funksionale.

Përdorimi i librit si mjet trajnimi

Stërvitjet moderne kërkojnë jo thjesht fuqi fizike, por analizë dhe planifikim. Leximi e mbështet këtë aftësi.

Partneriteti me institucionet arsimore

Ushtria mund të shërbejë si shembull për shkollat dhe universitetet, duke treguar se leximi është pjesë e disiplinës profesionale.

Arsimi i fortë, ushtri e fortë - Roli strategjik i leximit

Nëse ndërgjegjja shqiptare është themeli i shoqërisë, atëherë libri është themeli i ndërgjegjes. Shoqëria jonë me historinë e saj, sfidat dhe aspiratat ka nevojë për dije, qartësi dhe kulturë. Ka nevojë për libra.

Për Forcat e Armatosura, libri është pjesë e detyrës, e përgatitjes dhe e nderit profesional. Ai frymëzon urtësi, disiplinë dhe përkushtim tre vlera që e kanë mbajtur ushtrinë shqiptare gjithmonë të qëndrueshme dhe të respektuar.

Në një kohë kur sfidat evoluojnë çdo ditë, libri mbetet mjeti më i fuqishëm për t'i paraprirë, kuptuar dhe tejkaluar ato. Mbrojtja e vendit nuk fillon vetëm në kazermë apo në kufi; ajo fillon në mendjen e formuar dhe në zemrën e ndërgjegjshme të qytetarit dhe të ushtarakut.

Prandaj, rikthimi te libri nuk është thjesht një zgjedhje kulturore, por një domosdoshmëri strategjike për Shqipërinë dhe Ushtrinë e saj.

Shërbimi Kimik i Ushtrisë ka qenë një ndër shërbimet më elitare dhe më të rëndësishme të Forcave të Armatosura, një strukturë që përgjigjej drejtpërdrejt para Këshillit të Mbrojtjes për shkak të natyrës delikate, kompleksitetit dhe rëndësisë strategjike të detyrave që i ngarkoheshin.

Gjatë një periudhe 72-vjeçare, ky shërbim u ngrit mbi sakrificat dhe përkushtimin e qindra kuadrove dhe mijëra ushtarëve, të cilët punuan në kushte të vështira, por me përgjegjësi të lartë profesionale e njerëzore. Ishte një shërbim i domosdoshëm si në kohë paqeje, ashtu edhe në kohë lufte, një armë humane, që mbronte dhe shpëtonte jetë njerëzish në çdo situatë, duke garantuar mbrojtjen kundër agjentëve kimikë dhe pasojave të tyre.

Fillimet e shërbimit, themeli i një tradite të re (1953)

Nënreparti i parë i Mbrojtjes Kundërkimike u krijua më 21 nëntor 1953, me komandant kapitenin e talentuar Shyqyri Kondi. Kjo datë shënon lindjen e strukturës së parë të organizuar kimike në ushtrinë shqiptare. Paralelisht, pranë Shtabit të Përgjithshëm u ngrit edhe Dega e Mbrojtjes Kundërkimike, duke institucionalizuar kështu rëndësinë e mbrojtjes nga armët e dëmtimit në masë.

Kuadrot e para që u angazhuan në këtë armë ishin veteranë të Luftës Antifashiste dhe oficerë të përgatitur në shkollat ushtarake të Bashkimit Sovjetik, e më pas në Akademinë e Mbrojtjes. Emra të shquar si Shyqyri Kondi, Kristaq Haxhimihali, Hamit Murga, Uran Puto, Enver Lagji, Hysen Murtati, Sami Meçollari, Servet Muka e shumë të tjerë, vendosën themelet profesionale të këtij shërbimi.

Vitet e zhvillimit dhe rritjes teknike (1954–1970)

Në vitin 1954 u hap kursi i Kimisë pranë Shkollës së Bashkuar të Oficerëve, ndërsa me kalimin e viteve modernizimi i ushtrisë solli edhe fuqizimin e shërbimit kimik. Në vitin 1961 kompania e kimisë u pajis me teknikat e para të zbulimit dhe përpunimit kimik. Në vitin 1964, në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm u krijua dega e Mbrojtjes Kundërkimike, duke përgatitur kuadrot e larta drejtues.

Në vitin 1967, me vendim të Këshillit të Mbrojtjes, u ngritën tre batalione të specializuara në Tiranë dhe Berat: dy të mbrojtjes kundërkimike dhe një flakëhedhës, që shërbenin si Rezervë e Shtabit të Përgjithshëm. Po ashtu, në divizione dhe më vonë në korpuse u ngritën laboratorë kimikë dhe reparte të specializuara për riparimin dhe mirëmbajtjen e teknikës kimikë.

Krijimi i infrastrukturës shkencore ushtarake, Laboratori Qendror i Kimisë (1965)

Më 1 gusht 1966, u hap Laboratori Qendror i Kimisë në Forcat e Armatosura, nën drejtimin e kimistit të njohur Kudret Meta. Ky laborator u krijua me mision të qartë: studimin shkencor të armëve kimike, zhvillimin e teknikave të analizës, testimin e mjeteve mbrojtëse dhe prodhimin e materialeve ç'ndotëse.

Gjatë viteve 1965–2000, laboratori u shndërrua në qendër studimore të rëndësisë kombëtare, duke:

- sintetizuar sasi shumë të vogla të LHL-ve për qëllime testimi, përfshi edhe sarinë,
- studiuar aftësinë mbrojtëse të kundërgazeve dhe mjeteve të tjera kimike,
- zhvilluar përzierje djegëse për flakëhedhësit,
- prodhuar gypa indikatorë për lëndët helmuese luftarake dhe industriale,
- hequr nga importi një sërë kimikatesh të specializuara.

Industria kimike ushtarake shqiptare, një arritje e jashtëzakonshme

Në vitet '70 – '80, Shqipëria arriti të ndërtojë një industri të plotë të prodhimeve kimike ushtarake. Ndërmarrja e Prodhimeve Kimike të Ushtrisë, e njohur më vonë si "Rep. Ush. 1190", prodhoi:

- kundërgazin shqiptar (1971 – modeli eksperimental),
- paketat individuale kundrakimike,
- kompleti mbrojtës Nr. 1,
- kostumet mbrojtëse dhe ato të degazimit,
- karboni aktiv dhe katalitik (nga bërsi ulliri),

Shërbimi Kimik i Ushtrisë: Nga themeli te modernizimi i një Arme Elitare



- kutitë tymuese individuale dhe të tankeve,
- filtrat kolektivë 50 dhe 100 m³/orë.

Prodhimi vjetor i kundragazit arriti deri në 100.000 komplete/vit në vitet '80, një arritje domethënëse për një vend të vogël. Maskat prodhoheshin në Ndërmarrjen Gomë-Plastikë Durrës, ndërsa pjesë të specializuara realizoheshin me teknologji të avancuar vendase, përfshi presat metalurgjike të Kombinatit Metalurgjik Elbasan. Kjo industri e tërë u krijua falë vizionit dhe këmbënguljes të specialistëve shqiptarë, të cilët ngritën një kapacitet unik në rajon.

Programi i çmontimit dhe asgjësimit të Agjentëve Kimikë (2007)

Në vitin 2007, me mbështetjen e qeverisë amerikane dhe nën monitorimin e plotë të OPCW-së, Shqipëria realizoi me sukses asgjësimin e plotë

të të gjithë sasisë së agjentëve kimikë që trashëgoi nga periudha komuniste.

Sasia përfshinte:

- rreth 16 ton iprit mësimor,
- sasi të vogla klorpikrine,
- disa kilogramë iprit luftarak, luizit dhe sarinë,
- sasi të vogla të kloracetofenit.

Është e rëndësishme të theksohet se Shqipëria nuk ka pasur kurrë mjete përdorimi për këto lëndë vetëm komponentët e parë, të përdorur për studime shkencore.

Trashëgimia e Shërbimit Kimik

Historia 70-vjeçare e Shërbimit Kimik është një histori profesionalizmi të lartë, sakrifice dhe inovacioni. Ai u zhvillua në kushte të vështira, u ngrit

në nivele moderne dhe la pas një trashëgimi të rëndësishme shkencore, teknike dhe humane.

Sot, kjo histori mbetet një pasuri e Forcave të Armatosura, një shembull se si vizioni, profesionalizmi dhe përkushtimi mund të krijojnë struktura të forta dhe të dobishme për mbrojtjen e vendit.

Mbrojtja kundërkimike ka qenë dhe do të mbetet gjithmonë arma që ruan jetën, arma që nuk synon të shkatërrojë, por të mbrojë.

Në nderim të të gjithë specialistëve, ushtarëve, inxhinierëve dhe komandantëve që kontribuan për dekada në këtë shërbim, Forcat e Armatosura ngrenë sot me krenari këtë pjesë të historisë së tyre ushtarake.



Nga nënkolonel
LEONARD MUSOLLARI

Kur njeriu bëhet institucion

Në botën e ushtarakëve, ku fjala nder është peshë, ku përgjegjësia matet me jetë e jo me orë, të takon të njohësh njerëz që lënë gjurmë më të thella se uniforma që mbajnë. Unë pata fatin të jem bashkëpunëtor, koleg dhe mik i një prej atyre njerëzve të rrallë: Kolonel Agim Sula.

Për mua dhe për shumë të tjerë, Agimi nuk ishte vetëm një oficer i shquar, një jurist i brumosur, një pedagog i përkushtuar apo një studiues me mendje të mprehtë; Ai ishte dritë orientimi, busull profesionale, mik i sigurt, zemër fisnike. Ishte njeri që e ndjeje pranë edhe kur nuk fliste, sepse prania e tij përçonte qetësi, maturi, integritet.

Sot, teksa shkruaj këto rreshta, ndjej se nuk po shkruaj për një jetë të përfunduar, por për një jetë që vazhdon të jetojë në kujtime, në libra, në studentë, në kolegët e tij, në institucionet ku la gjurmë. Agimi nuk u largua. Ai vetëm u shndërrua në kujtim të përjetshëm.

I nisur nga rrënjët, një fëmijëri që modeloi një karakter të hekurt

E kam menduar shpesh se si formohen njerëzit e mëdhenj. Si bëhen ata që janë të pandryshueshëm në parime, të palëkundur në vlera, të përkushtuar ndaj atdheut.

Lindur më 3 korrik 1962, në fshatin Selitë të Tiranës, ai u rrit me vlera që sot po rrallohen: punë, besë, dinjitet, fjalë të mbajtur, dashuri për vendin.

Në familjen e tij mësohej që njeriu të mos matej me atë që thoshte, por me atë që bënte. Dhe Agimi i mbajti këto parime si flamur përgjatë gjithë jetës.

Që në moshë të re, talenti dhe disiplina e tij binin në sy. Nuk ishte fëmijë i zakonshëm, kishte një qetësi dhe pjekuri që pak adoleshentë e kanë. Kur vendosi të hynte në Shkollën Ushtarake “Skënderbej” në vitin 1977, ai bëri një zgjedhje që nuk do ta tradhtonte kurrë, zgjedhjen për t’i shërbyer atdheut.

Formimi nga Skënderbegas në Akademi

Shkolla “Skënderbej” i dha disiplinën, formën, strukturën. Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve i dha profesionin. Universiteti i Tiranës i dha dimensionin juridik. Studimet e avancuara i dhanë mendjen shkencore.

Por më shumë se kaq, të gjitha i dhanë vizionin.

Në çdo hap të karrierës së tij, kolonel Agimi nuk e shihte punën si detyrë, por si mision. Puna me të ishte një shkollë më vete asgjë nuk lihej pas dore, çdo detaj kishte rëndësi, çdo vendim mbështetej në arsyetim dhe dije të thellë.

Një nga cilësitë që kam admiruar më shumë tek kolonel Agim Sula ishte mënyra se si ai nuk e ndante njohurinë nga përgjegjësia. Për profesor Sulën, dija pa përgjegjësi ishte e paplotë. Kjo e bëri të jashtëzakonshëm në fushën e ligjit të konfliktit të armatosur një disiplinë e vështirë, e ndjeshme, dhe shumë pak e njohur në vendin tonë atë kohë.

Udhëheqësi i drejtë, i matur, i pakompromis me të padrejtën

Në punë me Agimin kisha mësuar një gjë: drejtësia nuk negociohet.

Nuk e kisha parë kurrë të humbiste toruan, as kur situatat ishin të nxehta, as kur presionet ishin të mëdha. E kishte një qetësi që nuk ishte thjesht temperament ishte profesionalizëm i shndërruar në art.

Sa herë kërkoja këshillë tek ai, nuk më jepte përgjigje të shpejta, mendonte me qetësi, dhe pastaj fliste pak, shkurt dhe saktë. Dukej sikur fjalët e tepërta i rëndonin.

Në postet që mbajti nga Shef i Edukimit në “Skënderbej”, pedagog në Akademinë e Mbrojtjes, Këshilltar Juridik në Shtabin e Përgjithshëm, e deri te posti i lartë i Komandantit (Rektorit) të Akademisë së Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, ai u soll gjithmonë me integritet të pasqyrtë. Studentët e adhuronin, oficerët e respektonin, komandantët e vlerësonin, sepse Agimi ishte një nga ata njerëz që nuk të imponohej me titull, por të bindte me karakter.

AGIM SULA, OFICERI I
NDERSHËM, MENDJA
E QETË DHE MIKU QË
NUK HARROHET

*Leonard Musollari: Agimi nuk u largua,
Ai vetëm u shndërrua në kujtim të përjetshëm*

Studiuesi, njeriu që e ngriti ligjin
e luftës në nivel akademik

Në literaturën ushtarake shqiptare, emri i tij ka një vend të rëndësishëm. Profesor Agimi ishte i pari që e luftoi paragjykimin se “ligji e kufizon ushtrinë”.

Për të, ligji ishte mburojë e jo pengesë.

Veprat e tij madhore: “Ligji i Konfliktit të Armatosur”, “Baza Ligjore e Operacioneve të Mbështetjes së Paqes”, janë sot bazë e pandashme e formimit juridiko-ushtarak në Shqipëri. Ishte autor i 48 artikujve shkencorë, programeve, manualeve, rregulloreve.



Kontributi i tij në hartimin e Statutit të Akademisë “Spiro Moisiu” mbetet themelor. Ai nuk shkruante për të mbushur faqe. Ai shkruante për të ndërtuar sistem.

Miku, njeriu i qetësisë, i fjalës së drejtë,
i zemrës së bardhë

Është e vështirë të flas për Agimin vetëm si koleg. Sepse për mua ai ishte, mbi të gjitha, mik. Një mik që e dalloje në çdo gjest, në çdo bisedë. Shpesh, në momente tensioni apo kur situatat bëheshin të rënduara, një fjalë e tij e thënë qetë dhe me maturi, mjaftonte për të kthyer gjithçka në vend. Kam parë tek ai një humanizëm që nuk e tregonte me fjalë, por me vepra, ndihmonte pa bërë zhurmë, këshillonte pa e llogaritur, falte pa e shpallur.

Largimi një dhimbje që nuk shuhet

Viti 2021, na mori shumë miq dhe shokë, mes tyre dhe kolonel Agim Sulën, lajmi i ndarjes së tij nga jeta ra si goditje e papritur dhe e padrejtë.

Shokët, kolegët, ish-studentët, e gjithë struktura e Forcave të Armatosura, humbën një intelektual të rrallë, një mik të dashur...

Fjala e një mikut që nuk e harron

Të shkruaj për kolonel Agim Sulën është një nder. Por është edhe një dhimbje.

Sepse shkruaj për një mik që nuk mund ta telefonoj më, për një koleg që nuk ulet më në tryezë me ne, për një njeri që do të donim ta kishim pranë edhe sot.

Për mua, Agimi mbetet: Oficeri i ndershëm, Juristi i urtë, Pedagogu i dashur, Studiuesi vizionar dhe Miku i patjetërsueshëm.



KOLONEL (R) ARBEN DHULI

Një historik retrospektiv i industrisë ushtarake në Shqipëri

Me shpalljen e pavarësisë, në vitin 1912, Shqipëria nisi të ndërtojë institucionet e saj ushtarake kombëtare. Gjatë Mbretërisë së Zogut (1928–1939), ushtria u organizua, por vendi mbeti i varur nga importi i armëve dhe pajisjeve ushtarake, kryesisht nga Italia. Kjo varësi, e kombinuar me mungesën e teknologjisë dhe mobilizimin e dobët, bëri që ushtria shqiptare të mos ishte në gjendje t'i rezistonte pushtimit italian të vitit 1939. Pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria u shndërrua në një shtet totalitar të izoluar, fillimisht aleat me Bashkimin Sovjetik dhe më pas me Kinën. Ushtria dhe industria ushtarake u organizuan mbi logjikën e kontrollit total shtetëror dhe vetë-mjaftueshmërisë. Në këtë periudhë u ngritën fabrikat kryesore ushtarake në Mjekës, Gramsh dhe Poliçan, të specializuara në prodhimin e armëve të lehta, municioneve, bombave të aviacionit, minave dhe pajisjeve të tjera ushtarake. Paralelisht, u ndërtua edhe një rrjet i gjerë bunkerësh në territorin shqiptar, të konceptuar si “mburojë” për mbrojtjen e popullsisë, strukturë që sot është bërë pjesë e peizazhit dhe kujtesës kolektive. Megjithëse gjatë viteve '60-'80 industria ushtarake synonte vetë-mjaftueshmërinë, teknologjia e përdorur ishte e vjetruar dhe izolimi politik dhe ekonomik kufizonte produktivitetin dhe zhvillimin teknik. Industria e mbrojtjes u ndërtua pothuajse tërësisht në funksion të një modeli vetëmbrojtës dhe në disa raste edhe për eksport në vende të treta, por pa një strategji afatgjatë modernizimi. Me ndryshimin e sistemit totalitar në fillim të viteve '90, kjo industri u përball me një krizë të thellë. Fabrikat që dikur punonin vetëm për ushtrinë humbën porosinë dhe mbështetjen shtetërore. Në vitin 1991, u krijua kompania shtetërore “MEICO”, me mision menaxhimin e armëve të mbetura dhe zhvillimin e ndonjë aktiviteti tregtar ndërkombëtar. Por në dekadat që pasuan, Shqipëria u orientua gjithnjë e më shumë drejt importit të armëve dhe pajisjeve, duke zbehur rolin e prodhimit vendas dhe duke e lënë industrinë e mbrojtjes pa një model të ri të integruar në arkitekturën e sigurisë euroatlantike.

Përpyjekjet e ringritjes së industrisë ushtarake dhe tendencat e fundit

Qeveria shqiptare ka miratuar projektligje dhe masa që synojnë në ndërtimin dhe zgjerimin e industrisë së mbrojtjes, fillimin e aktivitetit prodhues si dhe krijimin e mundësive edhe për eksportim të armatimeve. Një nga zhvillimet më të rëndësishme të viteve të fundit është themelimi, në vitin 2024, i shoqërisë shtetërore KAYO sh.a., me mision ringjalljen e industrisë ushtarake shqiptare. Kjo kompani trashëgon kapacitetet e fabrikave historike të Mjekësit, Gramshit dhe Poliçanit, duke synuar t'i përshtatë ato me kërkesat dhe standardet bashkëkohore. Ndërkohë që projekti “Shota MRAP”, “Made in Albania”, automjeti i blinduar i prodhuar nga kompania vendase “Timak”, është një prej sinjaleve të para konkrete të ringritjes së industrisë ushtarake; si dhe Kompania “Guna”, për prodhimin e pajisjeve individuale dhe uniformave ushtarake, etj.

RIJETËZIMI I INDUSTRISË USHTARAKE SI NJË SFIDË E KOHËS



Gjithashtu, modernizimi i infrastrukturës ushtarake, digjitalizimi, zhvillimi i teknologjive të reja (dronët, elektronikë ushtarake) dhe ndërveprimi me aleatët, janë komponentë thelbësorë në këtë strategji të re. Si konkluzion historik mund të themi që Shqipëria ka pasur një industri ushtarake relativisht të zhvilluar gjatë periudhës komuniste, por ajo u degradua pas tranzicionit demokratik. Sot po ndërmerren përpjekje serioze për ta ringjallur atë, me bazë në resurset ekzistuese historike dhe orientim drejt standardeve bashkëkohore, për të mbështetur nevojat kombëtare dhe potencialisht për t'u bërë një aktor eksportues në rajon.

Pse është i domosdoshëm rivitalizimi i industrisë së mbrojtjes?

Domosdoshmëria për të rivitalizuar industrinë ushtarake buron nga një kombinim faktorësh strategjikë, ekonomikë dhe gjeopolitikë. Pas Luftës së Ftohtë dhe rënies së kapaciteteve prodhuese, shumë vende të Ballkanit, përfshirë Shqipërinë, u bënë të varura nga importet për pajisje dhe armatime ushtarake. Rritja e tensioneve në rajon dhe në mjediset përreth NATO-s ka rikthyer në qendër të vëmendjes nevojën për kapacitete vendore të qëndrueshme. Mosmarrëveshjet e pazgjidhura historike në Ballkan, përplasjet e interesave të NATO-s dhe BE-së me ndikimin në rritje të Rusisë, Kinës dhe Iranit, si dhe pasiguria në arkitekturën globale të sigurisë, shtrijnë nevojën për një rishikim të politikave të mbrojtjes. Vendet janë të detyruara të mendojnë jo vetëm për numrin e trupave dhe armëve, por edhe për zinxhirët e furnizimit, aftësinë për mirëmbajtje dhe prodhim, si dhe pavarësinë strategjike. Në këtë kontekst, për një vend anëtar të NATO-s dhe aspirant për në BE si Shqipëria, rivitalizimi i industrisë ushtarake nuk është thjesht një opsion ekonomik, por pjesë përbërëse e detyrimit për të përmbushur standardet e interoperabilitetit dhe për

të kontribuar seriozisht në operacionet e përbashkëta të Aleancës.

Risku i varësisë nga furnizues të vetëm

Varësia e lartë nga furnizues të huaj krijon rreziqe në kohë krizash (si bllokada, embargo, rritje çmimesh etj.). Ndërtimi i kapaciteteve të brendshme ofron mundësi fleksibile si dhe aftësi për reagim të shpejtë në emergjenca. Industria e mbrojtjes vepron si një nxitës për sektorë të tjerë si: mekanikë, elektronikë, teknologji informative, dhe inovacion shkencor. Rivitalizimi sjell punësim të kualifikuar, rritje të eksporteve dhe rritje të konkurrueshmërisë së ekonomisë kombëtare. Ai shihet si një ringjallje e potencialit të humbur, i përshtatur me nevojat moderne. Rivitalizimi i industrisë ushtarake është domosdoshmëri për të rritur aftësinë mbrojtëse, për të forcuar pozicionin ndërkombëtar të Shqipërisë dhe për të zhvilluar teknologjikisht dhe ekonomikisht vendin. Nëse rrezikojmë të furnizohemi nga një furnizues i vetëm, atëherë investimet do të ekspozohen ndaj ndikimeve të huaja jo të favorshme dhe ndonjëherë kundërshtare. Furnizimi nga një burim i vetëm ndodh kur një ushtri apo shtet mbështetet tek një prodhues i vetëm (shtetëror apo privat) për një kategori të caktuar armatimi ose municioni (si raketa, predha, dronë, municione të artilerisë, etj.). Kjo quhet “single-source dependency” dhe është një pikë e dobët kritike në zinxhirin e furnizimit ushtarak. Furnizimi nga një burim i vetëm është një kërcënim i heshtur, por potencialisht fatal për një ushtri moderne. Në një epokë ku luftërat janë të shpejta, me një teknologji të lartë dhe të paparashikueshme, siguria nuk vjen vetëm nga fuqia e zjarrit, por nga fleksibiliteti dhe besueshmëria e zinxhirit të furnizimit. Në thelb, armët nuk janë thjesht mallra, por instrumente gjeopolitikë. Kur një shtet furnizues ka monopolin për teknologjinë dhe zinxhirin e furnizimit, ai kontrollon gjithçka. Nuk është hera e parë që bota përballlet me këtë fenomen pasi Ukraina, në vitet



para 2022-it, kishte varësi të madhe nga armatimi sovjetik dhe më vonë nga ndihma perëndimore. Kur furnizimet u vonuan, mbrojtja e saj ra nën presion të madh. Gjithashtu Turqia, një vend anëtar i NATO-s, përjetoi përplasje me SHBA-të për shkak të blerjes së sistemit raketor rus S 400. Si pasojë, u përjashtua nga programi i blerjes të avionëve luftarakë F 35 dhe përjetoi izolim teknologjik ushtarak. Por që ndërkohë Finlanda dhe Suedia, gjatë periudhave të neutralitetit, investuan qëllimisht në industrinë e tyre të armatimit për të shmangur këtë varësi, një politikë kjo e zgjuar që sot u ka dhënë pavarësi në integrimin në NATO. Për të pasur një ushtri funksionale, nevojitet pavarësi relative në furnizim, planifikim afatgjatë, dhe marrëdhënie të balancuara me partnerët ushtarakë. Në një epokë të pasigurt, siguria vjen nga zgjuarsia, jo nga besimi i verbër.

Roli i AIM-së në Rijetësimin e Industrisë Ushtarake

Rivlerësimi dhe modernizimi i kapaciteteve kombëtare do të fillojë me përditësimin e infrastrukturës së kërkim-zhvillimit, prodhimit, magazinimit dhe logjistikës, sipas standardeve të NATO-s dhe BE-së. Krijimi ose modernizimi i laboratorëve me pajisje të certifikuara sipas standardeve EN ISO dhe direktivave të BE-së, integrimi i platformave dixhitale për modelim, simulim dhe testim, në përputhje me standardet e NATO-s, do të shërbejnë për interoperabilitetin teknologjik. Automatizimi i proceseve prodhuese, zbatimi i mekanizmave të kontrollit dhe optimizimit, në përputhje me standardin EN ISO 9001, për menaxhimin e cilësisë dhe me kërkesat e AQAP (Allied Quality Assurance Publications), është faktor kyç për garantimin e cilësisë në sektorin e mbrojtjes. Planifikimi i proceseve, verifikimi, vlefshmëria dhe lidhjet me sistemet e auditimit dhe certifikimit duhet të jenë baza e fillimit të punës. Certifikimi i linjave të prodhimit sipas direktivave të BE-së për sigurinë në industri, si Machinery Directive, ATEX për mjedise me rrezik, është një nga kërkesat dhe parimet kryesore që do të ndjekë AIM. Ndërtimi dhe adaptimi i depove sipas rregulloreve AASTP-1 dhe AASTP-5 (NATO standards për ruajtjen

e eksplozivëve/municioneve) është një nga kërkesat jo vetëm të sigurisë por edhe të cilësisë së produkteve. Zbatimi i sistemeve inteligjente për gjurmim dhe kontroll të materialeve RFID, platforma digjitale për inventarizim, synohet të jetë baza dhe platforma e punës së AIM bazuar në standardet e vendosura për këtë proces. Në fushën e logjistikës së nevojshme kërkohet, përmirësimi i sistemeve të transportit dhe shpërndarjes sipas rregulloreve ADR/IMDG/IATA për mallrat e rrezikshme dhe Integrimi i standardeve të BE-së për Green Logistics (reduktim të karbonit, efikasitet energjetik). Po kështu në fushën e logjistikës do të synohet për një përshtatje me STANAG (Standardization Agreements) të NATO-s për ndërveprim logjistik dhe zinxhirin e furnizimit. Me këto standarde të vendosura do të arrihet të bëhet e mundur që këto kapacitete të jenë të certifikuara dhe në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar. Për të arritur deri këtu, duhet garantuar përputhshmëria me kuadrin ligjor kombëtar në fuqi, përfshirë aktet nënligjore dhe udhëzimet e institucioneve përgjegjëse. Përfshirja e industrisë ushtarake shqiptare në projekte të përbashkëta ndërkombëtare, është shumë e domosdoshme për të garantuar standardizim të plotë dhe zhvillimin e aftësive për të operuar në mjedise shumëkombëshe, ku Shqipëria dhe Forcat e saj të Armatosura janë palë. Licencimet, kontrolltet e eksporteve dhe certifikimet për kompanitë vendase, që ofrojnë produkte ose shërbime në sektorin e mbrojtjes, do të bëhen në përputhje me standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Forcimi i kapaciteteve kibernetike dhe mbrojtja nga kërcënimet hibride, do të arrihet me investime në teknologji të sigurisë kibernetike, sisteme paralajmërimi të hershëm dhe protokolle kundër dezinformimit.

Sekretari i Mbrojtjes së SHBA-ve, Pete Hegseth në një fjalim historik të mbajtur, më 1 tetor 2025, deklaroi në prani të gjeneralëve të Ushtrisë amerikane se “Epoka e departamentit të mbrojtjes ka përfunduar, epoka e departamentit të luftës ka filluar”. Kjo deklaratë rezulton të jetë si një kampanë alarmi që duhet të dëgjohet nga e gjithë bota. Kjo është veçanërisht e vërtetë për vende të vogla si vendi ynë, i cili, përballë sfidave të mëdha të sigurisë dhe mungesës së kapaciteteve industriale, ka vetëm një

rrugë të qëndrueshme përpara: bashkëpunimi si levë për rijetësimin e industrisë së mbrojtjes.

Zhvillimi i teknologjive të mbrojtjes kërkon investime të mëdha në kërkim dhe zhvillim (R&D), prototipizim dhe testim. Këto kosto janë të papërballueshme për vende të vogla në mënyrë individuale. Partneritetet do ndihmojnë në ndarjen e barrës financiare dhe përfitimin nga eksperiencia të konsoliduara ndërkombëtare. Për shkak të sfidave të përbashkëta (tensionet etnike, varësia nga importet, mungesa e zinxhirëve lokalë të furnizimit), bashkëpunimi mes vendeve të rajonit tonë përbën një mundësi strategjike. Kroacia dhe Sllovenia për shembull, kanë zhvilluar komponentë për prodhimin e automjeteve të blinduara në bashkëpunim kjo me kompani të mëdha europiane, duke përfshirë edhe partnerë rajonalë më të vegjël. Shqipëria po përpiqet të zhvillojë industrinë e saj të mbrojtjes në mënyrë jo të izoluar, pasi në këtë mënyrë ajo do të shmangë rrezikun e izolimit teknologjik dhe mungesën e standardizimit me partnerët e NATO-s. Shqipëria mund të krijojë një vlerë të shtuar për ekonominë e saj dhe të sigurojë mbrojtje efektive për interesat kombëtare, duke u pozicionuar si aktor serioz në arkitekturën e sigurisë në rajon. Bashkëpunimi është, në këtë kontekst, forma më moderne e sovranitetit inteligjent (smart).

Sfida e brezave dhe rindërtimi nga e para

Rijetësimi i industrisë së mbrojtjes në Shqipëri nuk është vetëm një proces teknik apo financiar. Ai përballtet me një sfidë të thellë gjeneratash. Brezi i vjetër i specialistëve që ka punuar në ndërmarrjet ushtarake gjatë periudhës komuniste është në pension ose pranë daljes në pension. Mungesa e transferimit të dijes dhe e shkollave profesionale të specializuara ka krijuar një boshllëk të ndjeshëm.

Ndaj, nuk mjafton thjesht “ringjallja” e një modeli të vjetër. Nevojitet një rindërtim i plotë, me një brez të ri inxhinierësh, teknikësh dhe specialistësh, të formuar në teknologjitë moderne: dronë, sisteme vëzhgimi, elektronikë ushtarake, siguri kibernetike, inteligjencë artificiale për mbrojtje. Kjo kërkon programe specifike universitare dhe profesionale, si dhe politika për “kthimin e trurit”, që të nxisin specialistët shqiptarë në diasporë të kontribuojnë në këtë fushë.

Ndërkohë vendet e vogla si Estonia dhe Kroacia kanë treguar se, nëpërmjet partneriteteve me kompani të huaja dhe fokusit në segmente të caktuara si sistemet kibernetike apo dronët është e mundur të ndërtohet një profil i qëndrueshëm në industrinë e mbrojtjes.

Rijetësimi nuk nënkupton domosdoshmërisht rikthimin te prodhimi klasik i armëve, por mund të fokusohet në teknologji të reja: siguri kibernetike, prodhim pjesësh 3D për dronë, pajisje inteligjente mbrojtëse, sisteme autonome dhe platforma të integruara me inteligjencë artificiale. Këto fusha kërkojnë bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat dhe start-up-et teknologjike.

Më shumë se një projekt teknik, një projekt kombëtar

Në kushtet aktuale të pasigurisë rajonale dhe globale, industria e mbrojtjes nuk është më një luks, por një komponent thelbësor i strategjisë së sigurisë kombëtare dhe zhvillimit ekonomik. Rivitalizimi i saj kërkon vizion politik, investime afatgjata, bashkëpunim ndërsektorial dhe integrim të ngushtë me strukturat e NATO-s dhe BE-së. Rijetësimi i industrisë së mbrojtjes është, në thelb, një përpjekje për të rikrijuar themelet e autonomisë strategjike të vendit. Pa një qasje që përgatit paralelisht njerëzit, dijet dhe teknologjinë, çdo investim rrezikon të mbetet kozmetik dhe i përkohshëm. Por një fillim i mbarë është gjysma e punës dhe ky vizion po bëhet realitet, nga ku Shqipëria ka kthyer një potencial të humbur në një aset strategjik për sigurinë dhe ekonominë kombëtare, dhe po pozicionohet si një aktor serioz në arkitekturën e sigurisë në rajon.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

KOZMA DUSHI, një jetë në skenë, një zemër mes fëmijëve

Në një pasdite të qetë vjeshte, në Tiranë, një takim i ngrohtë me Kozma Dushin shndërrohet në një udhëtim të thellë emocional. Artist, interpretues i dhjetëra këngëve të dashura, zë që ka shoqëruar breza të tërë, por edhe njeri me një thjeshtësi të rrallë, Kozma Dushi tashmë është në vitet e pensionit. Megjithatë, në sytë e tij ndriçon e njëjta dritë që e ka karakterizuar gjatë gjithë karrierës së tij. Në përballjen me të, gjithçka duket se lidhet natyrshëm, vitet e tij në skenë, puna e hershme me fëmijët e Qendrës së Kulturës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe ndjesitë që arti i ka dhënë përgjatë një jete të tërë.

“Pensioni është vetëm një fjalë”, - më thotë ai me një buzëqeshje të qetë. “Artisti nuk del kurrë në pension, për sa kohë zemra të rreh me ritmin e këngës”.

Që prej çastit të parë, bëhet e qartë se kjo nuk është thjesht një intervistë. Është një takim që mbart histori, kujtime, nostalgji dhe një thellësi që rrallë gjendet në botën e sotme të zhurmshme.



nga daljet e para në koncertet e rinisë, deri te festivalet kombëtare ku kënga dhe interpretimi i tij fituan zemrat e publikut, ai ka lënë gjurmë të pashlyeshme në kulturën shqiptare. Ai tregon se emocioni i parë i skenës mbetet i pashoq.

“Nuk harrohet kurrë momenti kur ngjitesh në skenë dhe ndjen se përballë ke një botë të tërë që të shikon drejt në sy”, - rrëfen ai. “Është një përgjegjësi, një privilegj dhe një dhuratë që nuk i përsëritet kujt do”.

Në vijim, ai përshkruan mbrëmjet e gjata pas koncerteve, momentet kur publiku e duartrokiste me ngrohtësi, por edhe ato çaste të heshtura të gardërobës, ku artisti mbetet vetëm me veten dhe me zërin e tij. Tregon për kohët kur udhëtonte nëpër qytete të vogla e të mëdha, ku njerëzit e prisnin me krahë hapur dhe muzikën e tij e konsideronin si një pjesë të jetës së tyre të përditshme.

Në skenë, përveç profesionalizmit, Kozma Dushi ka sjellë një lloj singleriteti që e ka bërë të dashur edhe për bashkëpunëtorët. “Një këngë duhet kënduar me shpirt”, - thotë. “Nëse nuk e bën me shpirt, atëherë je thjesht një zë. Arti nuk është zë, arti është zemër”.

**Vitet në Qendrën e Kulturës,
marrëdhënia me fëmijët**

Kapitulli i heshtur por i artë i karrierës së tij
Shumë pak njerëz e dinë se Kozma Dushi ka kaluar vite të çmuara në Qendrën e Kulturës së Ministrisë së Mbrojtjes, ku punoi me fëmijët e qendrës në aktivitete artistike, koncerte dhe programe edukative. Për të, kjo periudhë ka qenë

Ruga artistike, kujtime të skenës

Një jetë e mishëruar në art

Kozma Dushi ka jetuar dekada në skenë. Që





ndër më të bukurat dhe më kuptimplota.

“Fëmijët të japin një lloj energjie që nuk e gjen askund tjetër”, - shprehet ai me një emocion të dukshëm. “Ata nuk dinë të shtiren, nuk dinë të bëjnë sikur. Çdo reagim i tyre është i sinqertë. Dhe ai singëritet më ushqente”.

Ai kujton zërat e tyre të pastër, ritmin e hapave të vegjël nëpër korridoret e qendrës, emocionet e para që ata përjetonin para një shfaqjeje. “Ka fëmijë që qanin nga frika para skenës dhe unë u thosha: Mos kini frikë, skena është miku juaj. Sot, disa prej atyre fëmijëve janë rritur, janë bërë artistë, profesionistë... dhe ende më takojnë me respekt”.

Puna e tij me ta nuk ka qenë thjesht muzikore. Ai ka qenë një edukator, një mbështetës, një njeri që i ndihmonte të kuptonin se arti është më shumë se këngë: është disiplinë, përkushtim, besim në vetvete.

Takim, reflektim

Një takim që sjell emocione të vërteta

Gjatë takimit tonë, atmosfera ishte e ngrohtë, intime, e ngarkuar me histori. Të dy e ndjenim se po prekeshim nga diçka më

e madhe se një bisedë e zakonshme. Kozma Dushi fliste me thjeshtësi, por emocionet e tij ishin të thella dhe të ndjeshme.



KOZMA DUSHI KA
JETUAR DEKADA
NË SKENË. QË NGA
DALJET E PARA NË
KONCERTET E RINISË,
DERI TE FESTIVALET
KOMBËTARE KU KËNGA
DHE INTERPRETIMI I
TIJ FITUAN ZEMRAT
E PUBLIKUT, AI KA
LËNË GJURMË TË
PASHLYESHME NË
KULTURËN SHQIPTARE.
AI TREGON SE
EMOCIONI I PARË I
SKENËS MBETET I
PASHOQ.

Unë vetë përjetova atë emocion që vetëm një artist i vërtetë mund ta japë, një energji që nuk shuhet me vitet, por që ndriçon gjithmonë kur kujton skenën dhe publikun. Ai rrëfente me mall edhe momentet që sot i duken si ëndrra të largëta, por që kanë formuar identitetin e tij si artist dhe si njeri.

“Kjo jetë më ka dhënë shumë, - thotë ai. - Por mbi të gjitha, më ka mësuar të jem mirënjohës. Mirënjohës për skenën, për duartrokitjet, për njerëzit që më kanë dashur, për kolegët, por edhe për fëmijët e qendrës, të cilët më dhanë një gëzim që nuk e kisha njohur më parë”.

Ai reflekton edhe mbi pensionin: “Nuk është fundi i një rruge. Është thjesht fillimi i një kapitulli të ri. Tani kam më shumë kohë për të kujtuar, për të reflektuar, për të jetuar qetësisht me muzikën që ende e dëgjoj brenda meje”.

Trashëgimia e një zëri që
nuk shuhet kurrë

Ndërsa takimi ynë i afrohet fundit, mbetet e qartë se Kozma Dushi ka lënë një trashëgimi të fuqishme. Jo vetëm në skenë, por edhe në zemrat e atyre fëmijëve që e panë si mentor, në publikun që e duartrokiti për vite me radhë dhe në kulturën shqiptare që ai e pasuroi me përkushtim.

Kozma Dushi mbetet një figurë e dashur, një artist që nuk e ka humbur kurrë lidhjen me rrënjët e tij. Ai është dëshmia se arti nuk ka kufij moshe, nuk ka skadencë dhe nuk njeh fjalën “mjaft”. Arti është një rrugëtim që vazhdon edhe kur dritat e skenës fiken.

“Të këndosh, - e mbyll bisedën ai, - do të thotë të jetosh dy herë, një herë për veten dhe një herë për ata që të dëgjojnë”.

Luftëtare që ranë për çlirimin e kryeqytetit



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Bakushe Ismail Visha ra për një ideal të lartë

Bakushe Visha lindi në Tiranë në vitin 1928, në një familje të thjeshtë tiranase, ku që herët u formësua karakteri i saj i drejtë, i fortë dhe i përkushtuar ndaj çështjes kombëtare. Në një rrugicë të ngushtë të kryeqytetit ndodhej shtëpia e saj, prej ku vajza e re, me shpirt të zjarrtë revolucionar, dilte çdo ditë për të shpërndarë traktet e fshehura në gjirin e saj. Ky shteg i ngushtë i lagjes u bë fillimi i rrugëtimit të madh të Bakushes në shërbim të Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Terrori i pushtuesve nuk e trembi. Ajo mori pjesë në demonstratat antifashiste të rinisë tiranase dhe, ndonëse u arrestua dy herë, asnjëherë nuk hoqi dorë nga aktiviteti i saj. Vajzat dhe gratë e Tiranës, të mbajtura për vite nën kthetrat e fanatizmit e zakoneve të vjetra, e pritnin gjithmonë me mall Bakushen që u trokiste në dyer si një motër e dashur. Me fjalët e saj të ngrohta e të vendosura, ajo mbillte tek ato ndjenjën e revoltës, i ftonte të përkrahnin pa hezitim luftën popullore dhe t'i bashkoheshin idealit të madh të lirisë. Një ditë, teksa në qytet dëgjoheshin krismat e armëve, ajo i tha të vëllait: “Shokët vriten, kurse unë rri këtu...”.

Dhe dita e saj nuk vonoi. Në mars të vitit 1944, Bakushe Visha doli partizane, fillimisht në Grupin e Pezës, e më vonë në Brigadën XXIII Sulmuese. U shqua si një luftëtare e vendosur, sypatrembur, që gjendej gjithmonë në vijën e parë të përplasjeve. Ajo luftoi për çlirimin e Shqipërisë nga nazifashizmi, por edhe për çlirimin shpirtëror të vajzave dhe grave shqiptare nga prangat e paragjyqimeve. Për këto ideale të larta, Bakushja dha edhe jetën.

Më 4 nëntor 1944, gjatë sulmit të Brigadës XXIII Sulmuese kundër forcave naziste që tërhiqeshin, u plagos rëndë. Një mortajë gjermane i preu këmbën, por ajo nuk pranoi të largohej nga fusha e betejës. Duke i parë shokët që e mbanin në krahë, u lutej me zë të dridhur: “Shokë, më lini këtu... qëlloni mbi armikun! Unë po vdes e lumtur, pasi e jap jetën për një ideal të lartë...”. Bakushe Ismail Visha u shpall Dëshmore e Atdheut me vendimin nr. 129, datë 4.9.1947, të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Tiranë. Në nder të saj, një rrugë në kryeqytet mban sot emrin “Rruga Bakushe Visha”, për të kujtuar përherë jetën e saj të shkurtër, por plot shkëlqim, sakrificë dhe heroizëm.

Agllai Naun Tako: “Ngrini sa më parë flamurin e fitores”

Kur mori vesh se brigadës së saj i ishte besuar detyra e madhe për çlirimin e Tiranës, Agllai Tako u ndriçua në fytyrë nga gëzimi dhe krenaria: “Edhe unë do të jem luftëtare e çlirimit të Tiranës, e kryeqytetit tonë! Ç’nder i madh që na bëhet!”. Veshja partizane, kapela me yll në ballë dhe automatiku i shtërnguar në gjoks i jepnin një qëndrim burrëror. Në çastet e betejave, ajo s’ishte më vajza njomëzake me buzëqeshje miturake, por një luftëtare e vendosur. Automatiku ishte bërë tashmë shoku i saj i pandarë. Me brigadën, ajo zbriti nga kodrat e Shën Prokopit, nga rruga e Elbasanit dhe zonat e tjera përreth Tiranës. Çlirimi i kryeqytetit ishte çasti i madh që i afronte drejt lirisë së gjithë vendit. Në mendje i shfaqeshin qindra e mijëra njerëz të lumtur, që së bashku do të ndërtonin Atdheun e ri.

Me këto ëndrra në zemër, hyri në Tiranën e përflakur. Në qendër të qytetit një mitraloz armik gërgëriste pa pushim nga një bunker, duke penguar avancimin e partizanëve. Krismat e mitralozave dhe automatikëve përziheshin me krismat e armës së Agllaisë. Në rrugë endet një autobлиндë gjermane, si bishë e egër që qëllonte pa dallim. Agllaia ishte shtrirë barkas, me mitralozin gjerman të vendosur në dritaren e një pallati në shënjestër. Në çdo rrugë luftohej. Ngriheshin barrikada. Luftonte i madh e i vogël, Tirana mbarë ishte ngritur në këmbë. Vajza e vogël sypetrite, duke zvarritur trupin herë barkas e herë me vrap, i afrohej çerdhes së mitralozit që villote zjarr. Autoblinda e pengonte. Edhe bunkerit në qendër vazhonte të qëllonte pareshtur, duke mos e lejuar të kalonte rrugën.

Ç’ gëzim ndjeu kur pa që bunkerit u përflak dhe një granatë e fuqishme gozhdoi në vend autoblindën gjermane. Atëherë partizanët u ngritën në sulm. Agllaia qëllloi me vendosmëri kundër mitralozit të dritares. Shpërthimi që u dëgjua pak çaste më vonë tregoi se një shoku i saj e kishte asgjësuar çerdhen e armikut nga afër. Ajo u gëzua, por një pjesë e saj do të donte të kishte qenë vetë e para që t’i futej brenda atij zjarri. Në afërsi të Lanës, gjatë sulmit, hodhi një bombë, zbrazti një karikator të tërë, u shtri barkas për t’iu shmangur mitralozit gjerman dhe u ngrit sërish për të sulmuar. Por një plumb armik e preu në mes. Shokët e saj vazhduan betejën. Ajo i pa... Pa bunkerin që digjej dhe buzëqeshi. Me zërin e fundit tha: “Përpara shokë!”. Dhe mbeti aty, pranë Lanës, në prag të fitores së madhe.



Agllai Naun Tako është shpallur “Dëshmore e Atdheut” me vendim nr. 82, datë 17.08.1976, të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Përmetit.

Sose Musa Memushaj, luftoi përkrah të shoqit

Sose Musa Memushaj lindi në vitin 1924 në Bolenë, në një familje me tradita të forta atdhetare. E rritur në një vatër ku dashuria për vendin dhe ndjenja e përgjegjësisë shoqërore ishin pjesë e edukimit të përditshëm, ajo u përfshi natyrshëm në lëvizjen antifashiste. Në vitin 1942, Sosja u martua me Rustem Memushajn, gjithashtu nga Bolenë, nga një familje patriotë që e kishte shndërruar shtëpinë e saj në bazë të LANÇ-it. Në këtë shtëpi strehoheshin materiale luftarake të Brigadës V Sulmuese dhe pajisje të punëtorisë ushtarake të prapavijës. Për shkak të kësaj veprimtarie, shtëpia e tyre u dogj nga pushtuesit gjatë luftës. Rustemi, që nga fundi i dhjetorit 1942, iu bashkua çetës territoriale vullnetare të fshatit Bolenë, duke marrë pjesë në aksione të rëndësishme si në Gjorm, Borsh, në operacionin e dimrit 1943–1944, e në të tjera beteja. Në fund të marsit 1944, në fshat mbërriti lajmi se po formohej Brigada VIII Sulmuese dhe shumë të rinj, mes tyre edhe Rustemi, u inkadruan në radhët e saj. Kur Sosja përcolli burrin drejt brigadës, e shoqëroi me fjalët: - Të vafitë mbarë, Rustem! - Të kuptova, Sose, - iu përgjigj ai me vrap. - Do të gjej rastin të vij e të marr edhe ty. Unë do të pres, tha ajo me vendosmëri.

Sosja priti... por Rustemi nuk u kthye më në Bolenë. Ajo vendosi të mos e priste më pasive. Më 1 korrik 1944, kur një grup partizanësh të Brigadës VIII Sulmuese erdhi në fshat, duke mbartur një të plagosur, ajo mori guximin dhe deklaroi se donte të bashkohej me brigadën. U nis bashkë me partizanët, duke përkshuar male e gryka, derisa e gjeti brigadën në Zagori të Gjirokastrës. Komanda e mirëpriti dhe e caktoi në kompaninë e tretë të batalionit të tretë. Kur brigada po kalonte lumin e Vjosës drejt zonës së Beratit, Sosja vuri re midis radhëve të batalionit të parë bashkëshortin e saj. - Sose! - thirri Rustemi i shtangur nga habia. - Po, Rustem, unë erdhja, - iu përgjigj ajo. Të përqafuar, ata vendosën që luftën ta vazhdonin krah për krah. Sosja u dallua shpejt si partizane e shkathët, trimëreshë dhe e përkushtuar. Ajo ishte një aktiviste e zellshme e organizatës së rinisë dhe u zgjodh përgjegjëse e rinisë në kompani. Brigada VIII Sulmuese mori nga Shtabi i Përgjithshëm të UNÇSH-së, detyrën për të marrë pjesë në çlirimin e Tiranës. Në ditët e para të nëntorit 1944, brigada u vendos në kodrat e Saukut dhe Sharrës, ku mori urdhrin për të hyrë në luftime.

Më 11 nëntor 1944, kompania ku luftonte Sosja çliroi një pjesë të kazermave të Ali Rizait. Por gjermanët kundërsulmonin pareshtur. Predhat e artilerisë binin si breshër mbi pozicionet e partizanëve. Tym, flakë, dheu që trazohej – dukej se toka përreth ishte vënë në zjarr. Një copëz predhe e goditi Sosen në shpatull, por ajo nuk u tërhoq. Pak çaste më vonë, një tjetër predhë shpërtheu pranë saj. Shokët vrapuan drejt saj... por ajo nuk fliste më. Rustemi vazhdoi luftën deri në çlirimin e Tiranës. Dhimbjen për humbjen e Soses e mbajti në zemër, duke luftuar në aksionet e njëpasnjëshme të brigadës, e cila mbërriti deri në Vishegrad të Bosnjës. Pas çlirimit, Rustem Memushaj, tashmë komisar kompanie, u vra, më 31 gusht 1954, në Lezhë, nga plumbat e armiqve të pushtetit popullor.

Sose Musa Memushaj është shpallur Dëshmore e Atdheut me vendimin nr. 97, datë 22.09.1972, të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Vlorë. Rustem Riza Memushaj (1923-1945), partizan i Brigadës VIII Sulmuese, është shpallur Dëshmor i Atdheut me të njëjtin vendim.

Rukie Elez Roshi, dëshmorja që ra në portat e kryeqytetit

Në varrezat e Dëshmorëve të Atdheut në Peshkopi, ndër lapidarët që mbartin emra të pavdekshëm, prehet edhe Rukie Roshi – vajza e re që la pas ëndrrat e jetës për t’i dhënë vendit lirinë. Ajo ishte vetëm shtatëmbëdhjetë vjeçe, në lulëzimin e rinisë, kur ra heroikisht në luftë.

Rukia lindi në vitin 1927, në fshatin Begjunec të Dibrës, në një familje të thjeshtë, por me ndjenja të forta atdhetare. Që në moshë të vogël, jeta e saj u mbush me sprova: humbi prindërit dhe mbeti jetime që në moshën katër vjeçare. U rrit nën kujdesin

e njerëzve të huaj, duke punuar si shërbëse në shtëpitë e bejlerëve dhe afendikonjve. Fëmijëria e saj kaloi mes mundimeve e trishtimit. Shpesh fshihej në ndonjë qoshe të errët, me sytë plot lot, duke menduar për jetën e vështirë që i kishte rënë. Megjithatë, Rukia kishte një shpirt të ndjeshëm dhe një mendje të ndritur. E donte dijen dhe përpqiej të mësonte “me të vjedhur”, sa herë i jepej mundësia. Kur në vend u përhapën lajmet për pushtimin fashist të Shqipërisë, zemra e saj e re u drodh nga dhimbja. Një shoqe e fëmijërisë i tha një ditë: “Duhet të luftojmë, Ruke, jemi pa liri!”. Që nga ai çast, ajo e kuptoi se rruga e jetës së saj do të lidhej me fatin e popullit të robëruar.

E vendosur, Rukia iu bashkua lëvizjes çlirimtare dhe më pas radhëve të Brigadës IV Sulmuese, në batalionin e katërt. Që në përlëshjet e para tregoi trimëri të jashtëzakonshme. Ishte e shkathët, e guximshme dhe e papërkulur përpara rrezikut. Luftonte me pasion, me dashuri për shokët dhe për atdheun. Thuhet se në një betejë trup më trup, iu hodh një ushtari nazist dhe e kapri për gryke, duke e rrëzuar. Urrejtja e saj për pushtuesin dhe tradhtarët ishte e zjarrtë, si dashuria për lirinë. Në çdo pushim, në netët pranë zjarreve partizane, Rukia ishte gazi dhe gjallëria e shokëve. Këndonte, vallëzonte, sillte dritë dhe shpresë mes luftëtarëve. Të gjithë e donin për pastërtinë e shpirtit dhe për zemrën e madhe që kishte.

Në tetorin e vitit 1944, Brigada IV Sulmuese mori detyrën historike të çlironte Tiranën. Më 20 tetor, në përlëshjet e ashpra në Kashar, Rukia ishte në ballë të sulmit, krahas shokëve të saj. Plumbat armiqësorë e goditën në kraharor. U rrëzua në fushën e betejës, duke dhënë jetën për lirinë e kryeqytetit që po çlirohej. Lajmi i rënies së saj tronditi të gjithë brigadën. Partizanët u betuan për hakmarrje dhe për ta çuar në fund fitoren që ajo kishte ëndërruar.

Rukie Elez Roshi ra heroikisht në moshën 17-vjeçare, në portat e Tiranës – simbol i një brezi që flijoi rininë për atdheun. Emri i saj është skalitur në monumentet e kujtesës, në këngë, në vargje e në zemrat e njerëzve. Ajo mbetet përditësisht Dëshmore e Atdheut, vajza që u rrit jetime, por u bë bijë e lirisë.

Male Xheladin Bonaj, ra dëshmore në qendër të kryeqytetit

Male Bonaj lindi në vitin 1929, në fshatin Mezhgoran të Tepelenës, në një familje të thjeshtë, por me tradita të forta patriotike. Babai i saj, Xheladini, ishte një burrë i urtë dhe punëtor, ndër të parët që mori armët dhe doli luftëtar në çetën e Mezhgoranit në Luftën e Vlorës, më 1920. Në këtë frymë atdhetarie u rrit dhe u edukua edhe Maleja. Qysh e vogël, ajo pati parë luftimet që zhvilloheshin në zonën e saj, në përplasjet midis ushtrive italiane dhe greke. Megjithëse ende fëmijë, Male u përfshi në veprimtaritë e rinisë së fshatit, duke mbledhur materiale lufte, duke ndihmuar në transportimin e tyre dhe duke u rritur me ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vendit. Rënia heroike e Asim Zenelit në Mezhgoran ishte një mësim i madh për gjithë të rinjtë, shumë prej të cilëve dolën në mal partizanë... por ajo vetë ishte ende e parritur për të hyrë në radhë të luftës.

Në prill 1944, së bashku me një grup të rinjsh nga Mezhgorani dhe Tepelena, Male Bonaj u radhit partizane në Brigadën VIII Sulmuese. Ajo mësoi shpejt përdorimin e armës dhe u dallua për aftësi, guxim dhe përkushtim në çdo betejë. Batalioni i katërt, ku bënte pjesë edhe Maleja, përballoi me vendosmëri operacionin armik të qershorit 1944, në zonën Mali i Nemërçkës–Ura e Petranit–Përmet. Po ashtu, batalioni luftoi me ashpërsi gjatë operacionit të rrethimit “Uhu”, duke e çarë rrethimin me luftime të pandërprera në drejtimin Qafa e Dhëmbëlës–Mali i Poliçanit–Mali i Papingut. Male mori pjesë në luftime të rëndësishme, si ato kundër garnizonit armik në Gjirokastër dhe në Lazarat, në betejat për çlirimin e Konispolit, në mbrojtjen e Beratit në shtator–tetor 1944, si dhe në kalimin e lumit Shkumbin gjatë operacionit për çlirimin e Tiranës.

Brigada VIII Sulmuese kishte marrë detyrën të hynte në mësymje në sektorin Selitë e Vogël–Yzberisht. Më 12 nëntor 1944, batalioni i katërt, ku luftonte Maleja, avancoi drejt veriut dhe sulmoi pallatet e aviacionit, godinat e xhenios dhe fushën e druve në të dy anët e Lanës, në Tiranën e Re. Për ta ndaluar mësymjen, armiku solli përforcime të shumta: katër tanke, disa autoblinda dhe artileri. Luftime të ashpra u zhvilluan deri në agimin e 13 nëntorit, ku forcat hitleriane pësuan dëme të rënda dhe u tërhoqën në drejtim të rrugës së Kavajës dhe qendrës së kryeqytetit.

Në pasditen e 13 nëntorit, sektori i mësymjes së batalionit të katërt u spastrua plotësisht nga armiku. Në këto përlëshje trup me trup, ranë trimërisht partizani Rakë Selami nga Sevasteri i Vlorës dhe partizania Male Xheladin Bonaj nga Mezhgorani i Tepelenës, ndërsa pesë partizanë të tjerë u plagosën. Kujtimi i saj u përjetësua edhe në këngë popullore. Male Xheladin Bonaj është shpallur Dëshmore e Atdheut me vendimin nr. 44, datë 3.8.1971, të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Tepelenës.



KOLONEL (R) SALI ONUZI

Në të gjitha tekstet shkollore dhe akademike, historike dhe ushtarake, shënohet si datë e sulmit mbi Tiranë nga forcat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare 29 tetori 1944. Në fakt, siç rezulton, kjo është e vërtetë. E thonë në kujtimet e tyre edhe gjithë veteranët e luftës që kanë marrë pjesë në atë sulm, disa prej të cilëve për fat të mirë, jetojnë ende.

Por në dokumentet e botuara të Shtabit dhe të Komandës së Përgjithshme, si në botimet e bëra ashtu dhe në dokumentet që ruhen në Arkivin e Shtetit, nuk ka një urdhër me shkrim për sulmin mbi Tiranë, më datë 29 tetor ora 18.00. Ruhet dhe botohet dokumenti që përmban urdhrin e Komandantit të Përgjithshëm të UNÇSH-së, Enver Hoxhës, i datës 30 tetor 1944. Në fakt një sulm ishte kryer një ditë më parë.

Kjo ka shtruar pyetjen se cila ishte data e vërtetë e sulmit. Profesor dr. Paskal Milo në librin e tij “Udhëkryqe shqiptaro-gjermane”, shkruan: “Lufta e Tiranës sipas Shehut, që e ka përshkruar atë në kujtimet e tij, filloi më 29 tetor, një ditë para se Enver Hoxha të jepte urdhrin në emër të Shtabit të Përgjithshëm. Kjo mospërputhje në data për një ngjarje të rëndësishme të Luftës midis dy njerëzve më të fuqishëm të regjimit komunist, në kujtimet e tyre e në dokumentacionin e botuar, është lënë në heshtje nga historiografia e së kaluarës”.

Ashtu është, historiografia e së kaluarës, para vitit 1991, nuk e ka trajtuar këtë si një çështje dhe as nuk e ka sqaruar. Ajo i ka shënuar të dy datat. Madje atë të 30 tetorit e quan edhe si përfundim të urdhrin të mëparshëm. Madje edhe vetë Hoxha e Shehu, i kanë njohur dhe pranuar si datën 29 dhe datën 30 tetor. Kjo nuk është rastësi, as lëshim reciprok, madje as mospërputhje, por është një realitet.

Ka pasur përpjekje edhe për t'i afruar e shkrië në një, siç ka bërë komandanti i Korparmatës I, gjeneralmajor Dali Ndreu në një shkrim të botuar në “Luftëtari”, të datës 24 nëntor 1945, kur shkruan se “sulmi filloi natën, tuj gdh 30 tetor”. Pastaj Shehu nuk i ka dalë zot datës 29 tetor. Nuk gjendet as ndonjë urdhër i tij me shkrim për datën 29 tetor, sepse nuk ka pasur të tillë në fakt.

Sipas urdhrin të Komandës dhe të Shtabit të Përgjithshëm, divizioni dhe Korparmata I sulmuese që në shtator ishin përqendruar rreth Tiranës.

Më 2 tetor 1944, ka një urdhër të Korparmatës I për njësitë e saj vartëse për sulmin mbi Tiranë. Në këtë urdhër të Korparmatës në fakt është shpalosur një pjesë e planit të sulmit që do të bëhej mbi Tiranë (koha se kur nuk thuhet, por gjithnjë është fjala për sulmin që u bë më 29 tetor). Pra që nga 2 tetori deri më 29 tetor njësitë e korparmatës I S do të zinin pozicionet për të cilat urdhëroheshin dhe do të bëheshin gati për sulm. “Data dhe ora e sulmit, - shkruhet në urdhrin e 2 tetorit, - do të transmetohen me radiostacionin 12 orë më përpara”.

Mbi bazën e këtij urdhri të 2 tetorit të korparmatës I, Divizioni I S, më 6 tetor u ka nisur njësitë të tij (Br. I, IV dhe XXIII) urdhra për organizimin e forcave të tij në funksion të sulmit mbi Tiranë, për ta mbajtur armikun nën presion dhe për ta goditur vazhdimisht edhe brenda në qytet. Në këtë veprimtari ka ndërhyrë edhe aviacioni aleat, siç ndodhi më 25 tetor në Prezë – Ishëm, ku mbetën 100 gjermanë të vrarë dhe u dogjën 25 makina (sipas Kristo Themelkos, komisar i Divizionit I S).

Ndërkohë, si korparmata dhe divizioni I, vazhdonin të punonin për planet e këtij sulmi mbi Tiranë, ku do të përcaktoheshin për çdo brigadë e batalion drejtimet e goditjes, mbylljet e shtigjeve nga ku mund të hynte e të dilte armiku, lëvizjet e trupave sipas një numri variantesh të ndryshme të manovrimit të tyre, një varg goditjesh kundër autokolonave armike jashtë Tirane etj. Më 10 tetor Mehmet Shehu, komandant i Divizionit I, i kërkonte seksionit operativ të korparmatës I planin e Tiranës që kishin bërë gjermanët dhe informatat mbi vendosjen e forcave të armikut në qytet. Njëkohësisht Divizioni po grumbullonte edhe armatim e municion për këtë qëllim.

DY DATA PËR SULMIN MBI TIRANË, 29 APO 30 TETOR 1944?!



Enver Hoxha, Mehmet Shehu, Baba Faja Martaneshi, Omer Nishani etj., më 28 nëntor 1944 në Tiranë

Siç duket plani i zbërthyer për çdo brigadë, batalion, etj., u është dhënë komandave të tyre kohë më parë se të fillonte sulmi, në takime direkte me to, që ata të kishin mundësi ta detajonin më tej. Pritej vetëm koha, dita, ora dhe minuta i sulmit. Dhe sulmi, që ka filluar më 29 tetor ora 18.00, ka qenë një sulm i suksesshëm, madje nuk ka pasur asnjë partizan të vrarë atë natë. Ky sulm është bërë në kuadrin e sulmit të autorizuar nga komanda e përgjithshme dhe urdhrin të Komandës së korparmatës I S të datës 2 tetor 1944. Urdhri i 30 tetorit i është dhënë korparmatës I S, pasi kishte filluar sulmi i 29 tetorit me një sërë radiogramesh (nr. 43, 44,45,46,48 dhe 49).

As historiografia e periudhës moniste nuk e ka fshehur faktin se ndërsa sulmi i partizanëve të Brigadës I Sulmuese dhe njësitë të tjera ishte ndërmarrë, më 29 tetor 1944, urdhri i Komandantit të Përgjithshëm, Enver Hoxhës, për të sulmuar pushtuesit nazist e për të çliruar Tiranën, i ishte transmetuar korparmatës më 30 tetor, pra një ditë më vonë.

Për një ditë partizanët e Brigadës së Parë kishin hyrë në Tiranë, kishin përparuar shpejt dhe kishin zënë pozicione nga Medreseja deri të sheshi i sotëm “Avni Rustemi”. Nëse urdhri i 30 tetorit të Enver Hoxhës ishte për sulmin që u bë më 29 tetor, po të ishte e vërtetë kjo, atëherë duhen sqaruar disa çështje:

1. A kishin sulmuar pa urdhër partizanët!? Së paku pa urdhrin e Komandës së Përgjithshme. Mbetet atëherë të hetohet se si dhe pse u ndërmor ky sulm i 29 tetorit, ishte ai një aventurë apo një nevojë. Kush e urdhëroi dhe si?

2. Sulmi i Brigadës së parë dhe suksesi i saj e kujtuan Enver Hoxhën të jepte urdhër për sulm, apo dikush që e dinte projektin e urdhrin nga entuziazmi e mania për famë e lavdi, e shpërtheu këtë sulm para kohe?! Për çfarë nuk e ka akuzuar Hoxha Shehun, edhe për Luftën e Tiranës, sikur ai kishte lënë një shteg të hapur prej nga u tërhoqën forcat gjermane. Por është fakt se nuk e ka akuzuar që të ketë urdhëruar sulmin e 29 tetorit në kokë të vet.

Në ishte sulmi i Brigadës së Parë që e shpërgjumi Enver Hoxhën për të lëshuar urdhrin “historik”, del qartë se ç’ strateg “i madh” kishte qenë dhe vërtetohet ajo për të cilën e kritikojnë demokratët e sotëm, profanizmi ushtarak i tij.

Apo Enver Hoxha, i zënë në Berat me punë të shumta të veprimtarisë politike (Mbledhja e dytë e Këshillit të Përgjithshëm NÇ, Plenumi II i KQ të Partisë komuniste (kujto gjendjen e tij kritike në këtë plenum), nuk i ndiqte me kujdes (ose nuk dinte t'i ndiqte) situatat ushtarake? Por kur u njoftua për suksesin e Brigadës I dhe IV, dha urdhër “të sulmohej Tirana”.

“Enigma” zgjidhet, së pari, duke pasur parasysh rolin e komandës së Përgjithshme të UNCSH-së, e cila në përputhje me natyrën e Luftës dhe të Ushtrisë NÇ, jepte urdhra direktivë që u linin kohë, iniciativë dhe vetëveprim, po edhe përgjegjësi, komandave të njësitë vartëse. Kështu udhëzimin e saj për sulmin mbi Tiranë, ajo ua kishte dhënë me kohë (12 shtator) Korparmatës dhe Divizionit I S, të cilët punuan, hartuan dhe zbatuan plane konkrete për përgatitjen e sulmit të 29 tetorit.

Së dyti, nga analiza e radiogrameve të 30 tetorit, del qartë se urdhri që ato përmbanin është dhënë për përgatitjen e sulmit që u bë më 11 nëntor. Doemos që komandanti i Përgjithshëm do të lëshonte

një urdhër të tillë më herët, për t'i dhënë kohë korparmatës I të hartonte planin. Dhe kishte lënë në dorë të saj planin e sulmit, datën dhe orën. Ndërsa vetë kish mbajtur çështjet strategjike, të krijimit e të afrimit të brigadave që do të merrnin pjesë ne Luftën e Tiranës, etj.

Ky urdhër i 30 tetorit kërkonte të përgatitej një plan i kombinuar për sulmin vendimtar (siç është emërtuar nga historiografia). Në fakt, sulmi vendimtar, i përgatitur e i kombinuar në hapësirë e në kohë mbi Tiranë, filloi më 11 nëntor. Më 9 nëntor komandanti i Korparmatës I S, gjeneralmajor Dali Ndreu e bëri të njohur planin e këtij sulmi para përfaqësuesve të fuqive aleate, anglezë.

“Se në radiogramin e 30 tetorit nuk bëhet fjalë për sulmin e 29 tetorit, kjo kuptohet lehtësisht që në paragrafin e dytë të urdhrin të 30 tetorit, ku shkruhet që aksioni mbi Tiranë do të bëhet i kombinuar. Janë në lëvizje Brigada VIII dhe X... brigada II dhe XX, brigada e XII dhe XI... Dita që do të veprohet të na njoftohet sa më parë, që të lajmërojmë të gjithë forcat të bëjnë presion të madh në të katër anët”. Dhe së fundi, “Pa marrë parasysh përgatitjet e këtij plani, i cili duhet të zbatohet me çdo mënyrë dhe shpejt, duhet të bëni presion mbi Tiranën dhe, po të shihni mundësinë e marrjes, veproni pa humbur kohë”.



Gjeneralmajor Dali Ndreu, Komandant i Korparmatës I S

Shtabi dhe komanda e Përgjithshme qenë në dijeni të situatave. Këtë e shkruan edhe komandanti i korparmatës I, gjeneralmajor Dali Ndreu në shkrimin e tij të “Luftëtari” i vitit 1945. Ky sulm i 29 tetorit ishte pjesë e përgatitjeve për sulmin vendimtar mbi Tiranë. Ajo që i ka bërë disa ta konfundojnë me urdhrin e 30 tetorit është mos gjetja e një urdhri me shkrim për sulmin e 29 tetorit, koincidenca e tyre njëri pas tjetrit (29 dhe 30 tetor) dhe fjalia e fillimit të urdhrin “Duhet me e sulmue Tiranën”. Historiografia e mëparshme nuk e ka sqaruar çështjen duke menduar gabim se mos përjashtoj nga merita e 29 tetorit Hoxha.

Sulmi më 29 tetor filloi në periferi të Tiranës. Tirana e atëhershme si qytet fillonte nga Rruga “Bardhyl”. Por sulmi i Brigadës I S e tejkaloi objektivin, brenda një nate e një dite forcat e saj kishin hyrë brenda në Tiranë, gati në qendër të saj. Kur sulmi ishte në vijim, radiogrami që përmbante urdhrin e 30 tetorit po transmetohej e regjistronhej.

Kështu përfundimisht si data 29 dhe ajo e 30 tetorit kanë vendin dhe rolin e vet në historinë e luftës për çlirimin e Tiranës, ashtu siç e kanë edhe Shtabi e komanda e Përgjithshme, Korparmata I S dhe Divizioni I S dhe udhëheqësit e tyre: Enver Hoxha, Dali Ndreu, Hysni Kapo e Mehmet Shehu.



Tragjedia e Llogorasë, 22 nëntor 1989

Mbrëmja e 22 nëntorit 1989, mbetet një nga faqet më të trishta të historisë së aviacionit ushtarak shqiptar dhe një nga aktet më të dhimbshme të sakrificës njerëzore në paqe. Ajo çfarë nisi si një mision humanitar për shpëtimin e jetëve, përfundoi në një tragjedi të dyfishtë që shoi 23 jetë – pilotë, teknikë, mjekë, infermierë, pedagogë dhe studentë, duke lënë pas një plagë të pashërueshme në Forcat e Armatosura dhe në gjithë vendin.

Aksidenti i autobusit

Autobusi i Institutit Bujqësor, që udhëtonte drejt Kollosit me 14 studentë, 3 pedagogë dhe një ushtar, pati defekt fatal në të dalë të Himarës, në një tatëpjetë të fortë ku shoferi humbi kontrollin. Fjalët e fundit të tij, “U morëm në qafë!”, u bënë dëshmi e fundit e përpjekjes së dëshpëruar për të ndalur mjetin “Shkodra” që rrëshqiti rreth 70 metra në humnerë.

Në vend humbën jetën shoferi Ali Omuri dhe studenti Albert Smoka të tjerët, mes tyre pedagogu Misto Shumeli, mbetën të plagosur rëndë.

Ngjarja tronditi institucionet dhe strukturat ushtarake. Brenda minutave, u dha alarmi drejt Regjimentit të Farkës për aktivizimin e helikopterëve të gatishmërisë së menjëhershme.

Nisja e helikopterëve, detyra mbi gjithçka

Dy helikopterët MI-4, të njohur për qëndrueshmëri por edhe për kufizime të dukshme në mot të keq, u ngritën menjëherë në mision shpëtimi:

MI-4 nr. 644

- Komandant: Vangjel Postoli
- Pilot: Tafil Agaj
- Teknik: Pandeli Xhumba

MI-4 nr. 650

- Komandant: Agron Galanxhi
- Pilot: Veleidin Resuli
- Teknik: Enver Haka

Në bord u mor edhe ekipi mjekësor i spitalit nr. 2 të Tiranës: Agim Qarri, Kujtim Hysi, Dionis Makuçi, Zana Floqi dhe ndihmësmjekja Dhurata Leka.

Më vonë, gjatë kthimit, hipën edhe mjeku Nafail Metollari dhe ndihmësmjeku Piro Kuko nga spitali i Himarës.

Shiu i dendur, erërat e forta dhe ngarkesa elektrike në atmosferë e shndërruan misionin në një sfidë ekstreme. Megjithatë, bindja e thellë për të shpëtuar jetë i ngriti në ajër pa hezitim.

Komandanti i Regjimentit, Sinan Çela, i ndoqi nga kulla e kontrollit deri sa lidhja u shkëput përfundimisht.

Rrëzimi, misioni që nuk u kthye më

Pas rreth 50 minutash fluturim, helikopterët u ulën në Himarë, morën të plagosurit dhe u nisën drejt Tiranës. Në Farkë prisnin katër ambulanca – një shenjë e shpresës se tragjedia e parë mund të kthehej në shpëtim.

Por koha e keqe vendosi ndryshe...

Ora 17:55, Helikopteri i parë u përplas në shpatet e Karaburunit.

6–7 minuta më pas i dyti goditi terrenin malor pranë Vunoit. Askush në bord nuk mbijetoi.



Fluturojnë për të Shpëtuar, bien si Dëshmorë – Kronikë e 22 Nëntorit 1989



Vdiqën pilotët, teknikët, mjekët, infermierët, pedagogët Misto Shumeli dhe Thoma Plasa, si dhe 9 studentë që transportoheshin drejt Tiranës.

Reagimi i menjëhershëm

Në vendngjarje mbërritën ministri i Brendshëm Hekuran Isai, sekretari i parë i rrethit të Vlorës Enver Halili dhe rektori i Institutit Bujqësor, Haxhi Aliko. Por tragjedia kishte ndodhur tashmë; dy helikopterë dhe dy ekiye njerëzish të përkushtuar kishin humbur përgjithmonë.

Dëshmorë të Atdheut

Ushtarakët e Regjimentit të Farkës që u nisën në atë mision humanitar u shpallën “Dëshmorë të Atdheut”, duke u prehur

sot në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit. Emrat e tyre janë gur themeli në historinë e aviacionit ushtarak shqiptar.

Ky është nderimi më i lartë për njerëzit që, në kushte ekstreme, e vunë jetën e të tjerëve përpara të tyre.

Kujtesë dhe reflektim

“Tragjedia e Llogorasë” nuk është thjesht një episod i zi i së kaluarës. Ajo mbetet dëshmi e sakrificës së profesionistëve të Forcave të Armatosura, të cilët çdo ditë, në çdo kohë e në çdo mot, janë gati të nisen për të shpëtuar jetë.

Ky material le të shërbejë si kujtesë për brezat e rinj të uniformës, për studentët e aviacionit, për mjekët ushtarakë dhe për të gjithë ata që e kuptojnë se detyra ndaj jetës njerëzore është misioni më i lartë.

Uniforma si kredencial për inteligjencën artificiale

Si përvoja ushtarake po formon liderët e rinj në teknologji dhe AI

Teknologjia po përshpejton ritmin e zhvillimit njerëzor, ndërkohë që një burim i papritur i talenteve teknologjike po del në pah: Shërbimi Ushtarak. Në vend që të shihet si një rrugë paralele me karrierat në teknologji, përvoja ushtarake po shfaqet gjithnjë e më shumë si një trampolinë e fuqishme drejt fushave si inteligjenca artificiale (AI), siguria kibernetike dhe inxhinieria e sistemeve të avancuara.

Disiplina, qëndrueshmëria dhe vendimmarrja strategjike

Në thelb të çdo formimi ushtarak qëndron disiplina — një cilësi që nuk mësohet lehtë në auditore universitare apo në kurse online. Ushtarakët mësojnë të veprojnë me vendosmëri në kushte presioni ekstrem, të analizojnë situata komplekse me të dhëna të paplota dhe të marrin vendime që mund të kenë pasoja jetike. Këto aftësi janë të njëjta me ato që kërkohen në zhvillimin e sistemeve të AI-së, ku algoritmet duhet të marrin vendime në kohë reale, shpesh në skenarë të paparashikueshëm.

Në këtë kontekst, një oficer i trajnuar për të menaxhuar operacione të ndërlikuara në terren mund të jetë po aq i vlefshëm në një ekip që zhvillon inteligjencë artificiale për vetura autonome apo për sistemet e mbrojtjes kibernetike të një shteti.

Njohuri teknike të fituara në terren

Shumë role ushtarake moderne përfshijnë përdorimin dhe mirëmbajtjen e teknologjive të avancuara. Nga operimi i dronëve dhe radarëve inteligjentë, te përdorimi i sistemeve të komunikimit të koduar dhe analizës së të dhënave në kohë reale, ushtarakët shpesh trajnohen në teknologji që janë përpara tregut civil.

Për shembull: Njësitë e inteligjencës ushtarake përdorin algoritme të AI-së për të analizuar imazhe satelitore dhe për të parashikuar lëvizjet e armikut; Specialistët e mbrojtjes kibernetike trajnohen për të zbuluar dhe neutralizuar sulme digjitale, duke përdorur mjete që më pas përhapen në sektorin privat; Inxhinierët ushtarakë punojnë me robotikë, sensorë të avancuar dhe sisteme të automatizuara që më vonë gjejnë aplikim në industrinë civile.

Shqipëria, një bazë që po konsolidohet për leadership në Sigurinë Kibernetike dhe Teknologji Ushtarake

Në vitet e fundit, Shqipëria ka ndërmarrë hapa konkretë për të ndërtuar kapacitete të qëndrueshme në fushën e teknologjisë dhe sigurisë kibernetike, duke e pozicionuar shërbimin ushtarak jo vetëm si një strukturë mbrojtëse, por edhe si një inkubator për ekspertizë teknologjike.

Shqipëria po ndërton një infrastrukturë akademike serioze për të përgatitur profesionistë në ndërthurjen mes mbrojtjes dhe teknologjisë.



Akademia e Forcave të Armatosura: Një qendër akademike për teknologjinë dhe sigurinë

Forcat e Armatosura të Shqipërisë nuk janë më vetëm një strukturë operationale — ato po shndërrohen gjithashtu në një qendër akademike që përgatit profesionistë të nivelit të lartë në fushat më strategjike të kohës sonë. Nëpërmjet Akademisë së Forcave të Armatosura, ofrohen tre programe master që ndërthurin mbrojtjen, teknologjinë dhe diplomacinë:

- Master Profesional në “Siguri Kibernetike” në Fushën e Mbrojtjes

Ky program përgatit specialistë për të identifikuar, parandaluar dhe menaxhuar kërcënimet kibernetike që prekin infrastrukturën kritike të shtetit. Ai përfshin trajnime në analizën e rrezikut, mbrojtjen e rrjeteve dhe menaxhimin e incidenteve digjitale.

- Master Shkencor në “Siguri dhe Politikë Ndërkombëtare” në Fushën e Mbrojtjes

Ky program fokusohet në aspektet strategjike dhe diplomatike të sigurisë, duke përgatitur kuadro për të kuptuar dhe menaxhuar



sfidat globale të sigurisë, përfshirë luftën hibride, diplomacinë e mbrojtjes dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

- Master Shkencor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale” në Fushën e Mbrojtjes.

Një nga programet më të avancuara, ky master përgatit profesionistë në zhvillimin e sistemeve të automatizuara, analizën e të dhënave dhe aplikimin e inteligjencës artificiale në kontekste të mbrojtjes dhe sigurisë.

Këto programe nuk janë vetëm akademike — ato janë pjesë e një vizioni më të gjerë për të ndërtuar një elitë teknologjike me përvojë ushtarake, e cila mund të kontribuojë në: Mbrojtjen e sovranitetit digjital të vendit; Zhvillimin e teknologjive të sigurisë kombëtare; Bashkëpunimin me partnerë ndërkombëtarë në fushat e AI-së dhe sigurisë kibernetike.

Kjo qasje e integruar e bën Shqipërinë një nga vendet e pakta në rajon që po ndërton një ekosistem të qëndrueshëm të edukimit ushtarak me fokus në teknologjinë e avancuar. Në këtë mënyrë, shërbimi ushtarak nuk është më vetëm një detyrë ndaj atdheut, por edhe një trampolinë për karrierë në sektorët më të kërkuar të së ardhmes.



Qendra e Inovacionit, Sigurisë dhe Mbrojtjes, një pikë strategjike për teknologjinë ushtarake në Shqipëri

Në vitet e fundit, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të ndërtuar kapacitete të qëndrueshme në fushën e teknologjisë së mbrojtjes dhe sigurisë kibernetike. Një nga nismat më domethënëse është Qendra e Inovacionit, Sigurisë dhe Mbrojtjes, e cila funksionon në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes.

Kjo qendër përfaqëson një pikë takimi midis: Ekselencës ushtarake dhe kërkimit shkencor; Inovacionit teknologjik dhe sigurisë kombëtare; Talenteve të reja dhe përvojës institucionale. Qendra synon të: zhvillojë zgjidhje teknologjike për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, përfshirë inteligjencën artificiale, analizën e të dhënave dhe sistemet autonome; Të nxisë bashkëpunimin ndërmjet sektorit ushtarak, akademik dhe privat, duke krijuar një ekosistem inovacioni të qëndrueshëm; Të trajnojë dhe certifikojë profesionistë në fushat e teknologjisë së mbrojtjes, duke përfshirë sigurinë kibernetike, inxhinierinë e sistemeve dhe menaxhimin e krizave digjitale.

Qendra është gjithashtu një platformë për bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë, veçanërisht në kuadër të NATO-s dhe BE-së. Ajo mund të shërbejë si një model për vendet e tjera të Ballkanit që kërkojnë të ndërtojnë kapacitete të ngjashme në fushën e teknologjisë së mbrojtjes.

Për Shqipërinë, kjo qendër nuk është thjesht një institucion i ri — është një sinjal i qartë se vendi po e sheh teknologjinë jo vetëm si një mjet zhvillimi ekonomik, por edhe si një shtyllë të sigurisë kombëtare dhe sovranitetit digjital.

Komanda e Kibernetikës dhe Ndërlidhjes, boshti i Mbrojtjes Digjitale të Shqipërisë

Komanda e Kibernetikës dhe Ndërlidhjes është një nga strukturat më të rëndësishme të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, duke përfaqësuar një përqendrim të kapaciteteve teknologjike në fushat e komunikimit të sigurt dhe mbrojtjes kibernetike.

Kjo komandë është krijuar për të adresuar sfidat e epokës digjitale dhe për të integruar teknologjitë e avancuara në operacionet ushtarake dhe mbrojtjen kombëtare. Funksionet kryesore të saj janë: menaxhimi i ndërlidhjes ushtarake në kohë reale, për operacione të brendshme dhe ndërkombëtare, mbrojtja e rrjeteve dhe sistemeve kritike nga sulmet kibernetike, zhvillimi i kapaciteteve teknologjike për të përballuar luftën hibride dhe kërcënimet digjitale, integrimi i inteligjencës artificiale në analizën e të dhënave dhe automatizimin e proceseve ushtarake.

Komanda është gjithashtu një pikë referimi për formimin e kuadrove të rinj në fushat teknologjike, duke bashkëpunuar me Akademinë e Forcave të Armatosura dhe Qendrën e Inovacionit, Sigurisë dhe Mbrojtjes. Ajo ofron terren praktik për aplikimin e njohurive të fituara në programet master dhe për zhvillimin e ekspertizës në sigurinë digjitale.

Në këtë mënyrë, Komanda e Kibernetikës dhe Ndërlidhjes nuk është thjesht një strukturë teknike, ajo është një shtyllë strategjike në arkitekturën e mbrojtjes moderne të Shqipërisë, dhe një urë e fuqishme drejt karrierave të avancuara në teknologji.

Në këtë mënyrë, Shqipëria nuk është më thjesht një vend që ndjek trendet globale, por po ndërton themelet për të qenë pjesë aktive e arkitekturës digjitale të sigurisë dhe inovacionit. Nëse këto përpjekje mbështeten me politika të qëndrueshme dhe bashkëpunim ndërinstitucional, shërbimi ushtarak shqiptar mund të bëhet një burim i fuqishëm i talenteve teknologjike për dekadat që vijnë. Në vend që të shihen si dy botë të ndara, ushtria dhe teknologjia duhet të shihen si aleatë natyralë. Sepse, në fund të fundit, kush më mirë për të ndërtuar të ardhmen digjitale sesa ata që kanë mbrojtur të tashmen?





Shtoji Shqipërisë një yll

